



Zyra
Ndërkombëtare
e Punës
Gjenevë

Udhëzues për përgatitjen e Planit Kombëtar të Aksionit për Punësimin e të Rinjve



Udhëzues për përgatitjen e Planit Kombëtar të Aksionit për Punësimin e të Rinjve

Gianni Rosas dhe Giovanna Rossignotti

Programi për Punësimin e të Rinjve
Zyra Ndërkombëtare e Punës

E drejta e Autorit © Zyra Ndërkombëtare e Punës 2008
Botuar për herë të parë 2008

Botimet e Zyrës Ndërkombëtare të Punës gëzojnë të Drejtën e Autorit sipas Protokollit 2 të Konventës Universale të së Drejtës së Autorit. Megjithatë, pasazhe të shkurtra prej tyre mund të riprodhohen pa autorizim, me kusht që të përmendet burimi. Për të drejtat e riprodhimit apo përkthimit, duhet aplikuar pranë ILO Publications (Rights and Permissions), International Labour Office, CH-1211 Geneva 22, Switzerland, ose me email: pubdroit@ilo.org. Zyra Ndërkombëtare e Punës i mirëpret aplikime të tilla.

Libraritë, institucionet dhe përdorues të tjerë të regjistruar në Mbretërinë e Bashkuar nga Agjensia e të Drejtave të Autorit, 90 Tottenham Court Road, London W1T 4 LP [Fax: (+44) (0) 20 7631 5500; email: cla@cla.co.uk], në Shtetet e Bashkuara në Qendrën e të Drejtave të Autorit, 222 Rosewood Drive, Danvers, MA 01923 [Fax: (+1) (978) 750 4470; email: info@copyright.com] ose në vende të tjera në Organizata të të Drejtave per Riprodhim, mund të bëjnë fotokopje në përputhje me licensat lëshuar atyre për këtë qëllim.

ZNZ Zyra Ndërkombëtare e Punës –Gjenevë

Udhëzues për përgatitjen e Planit Kombëtar të Aksionit për Punësimin e të Rinjve
Gianni Rosas dhe Giovanna Rossignotti
2008

ISBN 978-92-2-821725-4 (print)
ISBN 978-92-2-821726-1 (web pdf)

Mund të gjendet gjithashtu edhe në Anglisht:
Guide for the preparation of national action plans on youth employment / Gianni Rosas
and Giovanna Rossignotti; International Labour Office – Geneva: ILO, 2008 72 p.;
ISBN 978-92-2-120616-3 (Print);
ISBN 978-92-2-120617-0 (Web .pdf);
ISBN 978-92-1-20618-7 (CD ROM);

dhe Serbisht:

Uputstvo za izradu nacionalnih akcionih planova za zapošljavanje mladih / Gianni
Rosas and Giovanna Rossignotti ; Međunarodna kancelarija rada. - Ženeva: MOR, 2007;
72 str.;
ISBN 978-92-2-820616-6 (print);
ISBN 978-92-2-820617-3 (web pdf);
ISBN 978-92-2-820618-0 (cd rom)

Përcaktimet e përdorura në Botimet e ZNP-së, që janë në përputhje me praktikën e Kombeve të Bashkuara, si dhe prezantimi i materialit, nuk nënkuptojnë shprehjen e ndonjë opinionit nga ana e Zyrës Ndërkombëtare të Punës në lidhje me statusin ligjor të ndonjë vendi, zone apo territori apo të autoriteteve të tyre respektive, apo në lidhje me vendosjen e kufijve të tij.

Përgjegjësia për opinionet e shprehura në artikujt, studimet apo kontributet e tjera të nënshkruara qëndron vetëm tek autorët e tyre, dhe botimi nuk përbën përkrahje nga ana e Zyrës Ndërkombëtare të Punës të opinionëve të shprehura në to.

Referencat ndaj emrave të firmave dhe produkteve e proceseve komerciale nuk përbën përkrahje të tyre nga Zyra Ndërkombëtare e Punës, dhe mospërmendja e ndonjë firme të vecantë, produkti apo procesi komercial nuk është shenjë mosaprovimi.

Botimet e ZNP-ës mund të merren përmes librashitësve të fuqishëm apo në zyrat lokale të ZNP-ës në shumë vende, ose drejtpërdrejtë nga ILO Publications, International Labour Office, CH-1211 Geneva 22, Switzerland. Katalogjet apo listat e publikimeve të reja janë të disponueshme falas në adresën e mësipërme ose me email pubvente@ilo.org.

Vizitoni faqen tonë të internetit: www.ilo.org/publns

PËRMBAJTJA

Falenderimet.....	7
Parathënia.....	9
Qëllimi i Udhëzuesit.....	11

Pjesa I. Procesi për përgatitjen e Planit Kombëtar të Aksionit për Punësimin e të Rinjve

1. Para se të angazhohemi në përpilimin e PKA-së.....	17
2. Fazat e sugjeruara për përpilimin e PKA-së.....	18

Pjesa II. Udhëzime për përpilimin e Planit Kombëtar të Aksionit për Punësimin e të Rinjve

1. Analiza e situatës.....	25
1.1 <i>Vështrim mbi kontekstin ekonomik dhe social.....</i>	<i>26</i>
1.2 <i>Analiza e tregut të punës së të rinjve.....</i>	<i>27</i>
1.3 <i>Rishikimi i politikave dhe programeve ekzistuese që prekin punësimin e të rinjve.....</i>	<i>30</i>
1.4 <i>Kuadri institucional dhe koordinimi i punësimit të të rinjve.....</i>	<i>37</i>
1.5 <i>Bashkëpunimi për zhvillim në punësimin e të rinjve (dy- dhe shumëpalësh, dhe IFN-ët).....</i>	<i>38</i>
2. Përcaktimi i politikave prioritare.....	39
2.1 <i>Identifikimi dhe analiza e problemit.....</i>	<i>39</i>
2.2 <i>Gjenerimi i opsioneve të politikave.....</i>	<i>41</i>
3. Planifikimi.....	45
3.1 <i>Qëllimi.....</i>	<i>45</i>
3.2 <i>Objektivat dhe synimet e punësimit të të rinjve.....</i>	<i>47</i>
3.3 <i>Rezultatet dhe treguesit kryesorë operacionalë.....</i>	<i>48</i>
3.4 <i>Burimet.....</i>	<i>49</i>
3.5 <i>Zbatimi dhe mekanizmat koordinues.....</i>	<i>51</i>
3.6 <i>Monitorimi dhe vlerësimi.....</i>	<i>53</i>
4. Identifikimi i dokumenteve që do t'i bashkëngjiten PKA-së.....	54
4.1 <i>Matricat e PKA-së.....</i>	<i>54</i>
4.2 <i>Plani i punës së PKA-së.....</i>	<i>54</i>
4.3 <i>Portofoli i projekteve të PKA-së.....</i>	<i>54</i>
4.4 <i>Normat Ndërkombëtare të Punës dhe legjislacioni vendas për punën dhe të rinjtë.....</i>	<i>55</i>

Pjesa III. Paketa e modeleve dhe matricave për Planin Kombëtar të Aksionit për Punësimin e të Rinjve

Mjeti 1:	Skica dhe përmbajtja e propozuar e dokumentit të PKA-së	59
Mjeti 2:	Treguesit për paraqitjen e gjendjes së përgjithshme të tregut të punës	60
Mjeti 3:	Lista e plotë e treguesve kryesorë lidhur me tregun e punës për të rinjtë	62
Mjeti 4:	Matricat për përshkrimin e niveleve të ndryshme të sistemit të edukimit	63
Mjeti 5:	Kriteret për vlerësimin e performancës dhe impaktit të projekteve / programeve	64
Mjeti 6:	Shembuj çështjesh dhe pyetjesh që lidhen me vlerësimin e PKA-së	65
Mjeti 7:	Modeli i matricave të PKA-së.	66
Mjeti 8:	Modeli i propozuar për planin e punës për PKA-në.	67
Mjeti 9:	Modeli i propozuar për skicë-projektin e PKA-së.	68
Mjeti 10:	Normat Ndërkombëtare të Punës për punën dhe të rinjtë	69

Tabelat, kutizat dhe figurat

Tabela 1.	Pjesët e ndryshme të Udhëzuesit	13
Kutiza 1.	Partneriteti në zhvillimin e PKA-së	19
Kutiza 2.	Treguesit e tregut të punës dhe përkufizimet.	29
Kutiza 3.	Regjistri i fushave kryesore të politikave që kanë të bëjnë me punësimin e të rinjve.	41
Kutiza 4.	Kriteret për renditjen e opsioneve të politikave.	42
Kutiza 5.	Kërkesat kryesore të politikave publike ...	43
Kutiza 6.	Përmbajtja e dokumentit të SRV (Strategjia për Reduktimin e Varfërisë)	46
Kutiza 7.	Objektivat dhe synimet për punësimin e të rinjve	47
Kutiza 8.	Punësimi i të rinjve në Strategjinë Evropiane të Punësimit. ...	48
Kutiza 9.	Rezultatet dhe treguesit e punësimit të të rinjve.	50
Kutiza 10.	Shembulli i mekanizmit koordinues për zbatimin e Planit Aksional Nacional të Kosovës për Punësimin e të Rinjve.	52
Kutiza 11.	Kriteret kryesore për vlerësim	52
Figura 1.	Cikli i politikave.	12
Figura 2.	Shembulli i marrëdhënies shkak-pasojë (pema e problemit) i numrit të madh të femrave të reja në ekonominë informale ...	40
Figura 3.	Shembulli i marrëdhënies shkak-pasojë (pema e problemit) i nivelit të lartë të papunësisë ndër të rinjtë.	40

Falënderimet

Ky udhëzim është përgatitur nga Gianni Rosas, Specialist i Punësimit në Zyrën Rajonale për Evropën Qendrore dhe Lindore të ONP-së, dhe Giovanna Rossignotti, Koorditore e Programit për Punësimin e të Rinjve në Zyrën Qendrore të ONP-së.

Falënderime të veçanta shkojnë për Jose Manuel Salazar-Xirinachs, Drejtor Ekzekutiv i Sektorit të Punësimit në ONP, për inspirimin dhe mbështetjen e kësaj nisme, dhe për Mariangels Fortuny, Specialiste për Politikën e Punësimit në ONP, për kontributin e çmueshëm profesional.

Autorët dëshirojnë të shprehin mirënjohje për një numër të madh kolegësh në përfaqësitë e ONP-së dhe në Zyrën Qendrore të cilët kanë dhënë shumë komente në draftet e para të këtij botimi: Redha Ameer, Valli Corbanese, Sabine Dewan, Jose Carlos Ferreira, Vladimir Gasskov, Claire Harasty, David Lamotte, Elizabeth Morris, Alena Nesporova, Hopolang Phororo, Emily Sims, Diego Rei, Jurgen Schwettman, Manuela Tomei, Amy Torres, Corine Vargha, Francisco Verdera, Catherine Vaillancourt-Laflamme, se bashku me Laura Bewer dhe Regina Monticone nga Sekretariati i Rrjetit për Punësimin e të Rinjve. Janet Mutlow ofroi mbështetje administrative dhe ndihma të tjera.

Parathënie

Gjatë dekadës së kaluar, punësimi i të rinjve ka marrë rëndësi në axhendat kombëtare dhe globale të zhvillimit, duke dëshmuar përmasat e kësaj sfide me të cilën po përballen gjithë vendet, pavarësisht nivelit të zhvillimit social-ekonomik të tyre. Angazhime për arritjen e synimit të vendosur në nivel ndërkombëtar për një punësim të plotë dhe produktiv dhe për punë të denjë për të rinjtë janë marrë dhe iniciuar në shumë forume ndërkombëtare, si në Samitin Botëror të 2005. Edhe pse janë shënuar disa suksese, problemi i punësimit të të rinjve mbetet një sfidë për shumicën e shteteve.

Megjithatë, ka një ngritje të vetëdijes se punësimi produktiv dhe puna e denjë për të rinjtë nuk mund të arrihen përmes ndërhyrjeve të fragmentuara dhe të izoluara. Porse është e nevojshme që të ketë një aksion të qëndrueshëm, të vendosur dhe të bashkërenduar nga një spektër i gjerë aktorësh. Me rëndësi është që të ekzistojë një qasje koherente që do të rezultojë me politika mbështetëse të orientuara në dy elemente bazë: në njërin anë, në një strategji integruese për ngritje ekonomike dhe krijim të vendeve të reja të punës, dhe, në anën tjetër, në ndërhyrje të targetuara që do t'i ndihmonin të rinjtë të kapërcejnë vështirësitë për të hyrë dhe qendruar në tregun e punës. Kjo në realitet është edhe qasja thelbësore e Axhendës për Punësim të Tërësishëm të ONP-së, e përfshirë gjithashtu në Rezolutën për punësimin e të rinjve që u miratua në Konferencën vjetore të ONP-së në vitin 2005, dhe që ofron kuadrin bazë për këshillimin e shteteve anëtare që në përpjekjet e tyre të synojnë për një ekonomi dhe treg pune më eficient, më të hapur dhe më të paanshëm.

Njohuritë e deritanishme tregojnë se madhësia e problemit të punësimit të të rinjve kërkon që të punojmë në partneritet. Porse është e ditur se përgjegjësia kryesore për të nxitur punësimin e të rinjve i takon Shtetit. Për këtë arsye, ndërmjet institucioneve qeveritare, si në nivelin qendror edhe në atë lokal, është e nevojshme të ketë koherencë, koordinim dhe bashkëpunim. Edhe kjo qasje, e vetme, nuk është e mjaftueshme. Qeveritë kanë nevojë të kenë mbështetjen e ndërmarrjeve, të cilat, nga ana e tyre, kanë nevojë për fuqi punëtore të kualifikuar, të kenë partnerë socialë të angazhuar si dhe të kenë bashkëpunimin e grupeve të të rinjve dhe të shoqërisë civile. Më shumë koherencë politikash në nivel kombëtar e ndërkombëtar brenda sistemit të Kombeve të Bashkuara dhe Institucioneve të Bretton Woods është po ashtu e nevojshme në mënyrë që të ndihmohen shtetet në arritjen e Objektivave Zhvilluese të Mijëvjeçarit, e në veçanti që të rinjve, kudo, t'i ofrohen mundësi për punë të denjë. Rrjeti i Punësimit të të Rinjve – aleancë e OKB-së, Bankës Botërore dhe ONP-së - është shembulli i një partneriteti global që përpiqet për një koherencë dhe koordinim më të mirë si dhe këmbim të njohurive në sferën e punësimit të të rinjve.

Ky udhëzues është hartuar në përgjigje të rezolutave të OKB-së që ftojnë Organizatën Ndërkombëtare të Punes, në kontekstin e Rrjetit për Punësim të Rinjve dhe në bashkëpunim me Sekretariatën e OKB-ës, Bankën Botërore dhe Agjensi të tjera të specializuara të Kombeve të Bashkuara, të mbështesin qeveritë në përpilimin e Planeve Kombëtare të Aksionit për Punësimin e të Rinjve (PKA). Këto PKA nuk janë një qëllim në vetvete, e as që janë të vetmet instrumente që shtetet mund të përdorin për ta bërë punësimin e të rinjve një objektiv qendror të politikave kombëtare sektoriale dhe zhvilluese. Megjithatë, ato mund të shërbejnë si një mekanizëm i dobishëm dhe mjet livruar për një qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse të punësimit të të rinjve që bazohet në kontributin dhe angazhimin e shumë aktorëve.

Ky Udhëzues do të udhëheqë veprimtarinë e ONP-së në punësimin e të rinjve në vitet e ardhshme si dhe do t'i bëjë të ditur palëve të shteteve anëtare politikatat që iu këshillojmë në kur ndërmarrin përpilimin e PKA-së për nevojat e veta. Ne besojmë se ky udhëzues do të shërbejë edhe për politikëbërësit, organizatat e punëdhënësve dhe punëmarrësve, grupet rinore dhe aktorët e tjerë të zhvillimit si një material kornizë për t'i drejtuar aksionet e tyre drejt qëllimit të një punësimi produktiv dhe pune të denjë për të rinjtë – qëllim ky që është qenësor për një zhvillim dhe progres shoqëror.

Jose Manuel Salazar-Xirinachs
Drejtore Ekzekutive
Sektori i Punësimit
ONP

Qëllimi i Udhëzuesit

Ky udhëzues ka për qëllim që t'i përgjigjet nevojës së shteteve për të pasur një kuadër për hartimin e Planeve Kombëtare të Aksionit për Punësimin e të Rinjve, siç vihej në dukje në raportet e paraqitura nga 41 shtete ku bëhej analiza dhe vlerësimi i parë global i PKA-ve¹. Më saktësisht, ky dokument është dizajnuar për të:

- siguruar të kuptuarit e përbashkët (në mes partnerëve vendas dhe ndërkombëtarë) të procesit që kërkon të mbështesë vendet për përgatitjen e PKA-ve,
- sugjeruar një qasje praktike hap-pas-hapi për përpilimin e PKA-së përmes një procesi të bashkërenduar dhe të koordinuar çka përforcon komponentin e pronësisë kombëtare mbi PKA-në,
- ofruar udhëzime për shtetet - në veçanti për zyrtarët qeveritarë, përfaqësuesit e organizatave të punëdhënësve dhe punëtorëve, grupet rinore dhe aktorët e tjerë relevantë - që të punojnë së bashku në përgatitjen e një PKA-je të balancuar dhe gjithëpërfshirëse,
- ofruar mjete metodologjike për ONP-në dhe agjenci të tjera ndërkombëtare përmes të cilave ato do të mund të kenë një qasje të përbashkët për dizajnimin e strategjive për punësim të të rinjve, veçanërisht, të PKA-ve.


Ky Udhëzues tregon procesin e dëshiruar ku bazohet zhvillimi i PKA-së si dhe kuadrin substancial që synon të mbështesë zhvillimin e saj. Çka është më me rëndësi, PKA-ja, siç është konceptuar në këtë Udhëzues, është një dokument pune – një metodologji që orienton aksionet e një vendi tek punësimi i të rinjve në bazë të marrëveshjes së përbashkët të arritur mes gjithë palëve të interesuara.

Procesi i propozuar ka në konsideratë faktin se problemet e punësimit të të rinjve nuk mund të trajtohen përmes ndërhyrjeve të fragmentuara e të izoluara. Porse, ato kërkojnë një aksion të qëndrueshëm dhe të bashkërenduar - nga shumë aktorë – në një sërë fushash të politikave të punësimit. Ndaj, pjesëmarrja dhe dialogu janë një kusht i domosdoshëm për përpilimin e PKA-ve që efektivisht përmbushin nevojat në terren dhe i përgjigjen nevojave të partnerëve vendas të interesuar. Megjithatë format e angazhimit të këtyre aktorëve ndryshojnë prej shtetit në shtet, Udhëzuesi sugjeron që të identifikohen, qysh në fillim, të gjithë aktorët që do të jenë të përfshirë në procesin që do të konsiderohet si pronësi nacionale si dhe rolet e tyre përkatëse në mënyrë që të bazohemi në njohuritë dhe përvojën e një numri të gjerë aktorësh.

Kuadri i sugjeruar për zhvillimin e PKA-së është bazuar në trajtimin e ciklit të politikave - që nënkupton analizën e situatës dhe identifikimin e problemeve kryesore, gjenerimin e opsioneve të politikave dhe planifikimin

¹ Shih Kombet e Bashkuara: *Analiza dhe vlerësimi global i planeve kombëtare të aksionit për punësimin e të rinjve*, Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm, (A/60/133), Korrik 2005 dhe *Rishikim i Planeve Kombëtare të Aksionit për Punësimin e të Rinjve: Angazhimet të kthehen në aksion*, New York, 2007

Figura 1: Cikli i politikave



për zbatim (shih Figurën 1). Me fjalë të tjera, hapat e kuadrit të propozuar mbulojnë gjithë ato aspekte të zhvillimit që janë instrumentale dhe që çojnë drejt miratimit të politikave për punësimin e të rinjve si dhe drejt zbatimit të tyre.

Udhëzimet që mbështesin kuadrin e sipërpërmendur nuk janë të ngurta dhe as sugjerojnë metodat e zbatimit të PKA-ve. Ato, më tepër, tregojnë komponentët kryesorë dhe përmbajtjen e dëshiruar të PKA-së, që mund të rregullohen në përshatje me kushtet vendase. Ndërkohë që qasja e propozuar duhet të konsiderohet si një kuadër i përbashkët, në ato vende ku mungon informacioni mund të aplikohen disa fleksibilitete. Mjeti 1 ofron një propozim të rubrikave dhe përmbajtjes së një dokumenti PKA-je.

Të gjithë komponentët janë të ndërlidhur dhe plotësimi i detyrave të secilit komponent mundëson kalimin në komponentin vijues (për shembull, analiza e situatës është thelbësore për identifikimin e problemeve kryesore dhe përcaktimin e zgjidhjeve si dhe për planifikimin e aksioneve të nevojshme).

Ky udhëzues është i ndarë në tri pjesë kryesore. Pjesa e I-rë përshkruan disa çështje që duhen konsideruar kur merret vendimi për përpilimin e PKA-së dhe propozon hapat e njepasnjëshëm të përpilimit që kryhet si një proces me pjesëmarrje të gjerë, çka siguron pronësinë nacionale mbi PKA-në. Pjesa e II-të paraqet kuadrin teknik për përpilimin e PKA-së dhe në të njëjtën kohë ofron udhëzime praktike. Kjo pjesë ndahet në katër seksione. Tri seksionet e para përmbajnë përmbledhjen e qëllimit dhe udhëzimet bazë për punën që duhet bërë (të paraqitura në kutiza) dhe, përmes një pakete detyrash, tregohet informacioni që duhet mbledhur dhe analizuar kur përpilohen pjesët e caktuara të PKA-së. Seksioni i katërt përshkruan dokumentet e ndryshme që i duhen bashkëngjitur PKA-së. Pjesa e III-të ofron mjete shtesë dhe materiale për referim. Tabela 1 jep një përshkrim të përmbledhur të seksioneve të ndryshme të Udhëzuesit.

Tabela 1: Seksionet e ndryshme të Udhëzuesit

Seksioni	Përshkrim i Përmbledhur
PJESA I. Procesi për përgatitjen e PKA-ve	
<i>Para se të ndërmarrim përpilimin e PKA-së</i>	Përshkruan disa çështje që duhen konsideruar kur merret vendimi për të përpiluar një PKA.
<i>Fazat e propozuara për përpilimin e PKA-së</i>	Sugjeron gjithë hapat e procesit praktik për të përpiluar një PKA që mbështetet në pronësinë nacionale me bazë të gjerë.
PJESA II. Udhëzimet për përpilimin e PKA-së	
Seksioni 1. Kryerja e analizës së situatës	
<i>Vështrim mbi kontekstin ekonomik dhe social</i>	Shënohen tendencat e treguesve kryesorë makroekonomikë dhe parashikimet e politikave makroekonomike, sektoriale dhe sociale për punësimin e të rinjve.
<i>Analiza e tregut të punës së të rinjve</i>	Orienton analizën e treguesve kryesorë të tregut të punës së të rinjve, konkretisht: tendencat demografike dhe të arsimit, treguesit e fuqisë punëtore, shkallët e pasivitetit, pagat dhe kushtet e punës.
<i>Rishikim i politikave dhe programeve ekzistuese që ndikojnë në punësimin e të rinjve</i>	Ndihmon në vlerësimin e politikave dhe programeve ekzistuese të punësimit dhe tregut të punës që ndikojnë në këto sfera për punësimin e të rinjve: i) arsim dhe trajnim, ii) zhvillim i ndërmarrjeve; dhe iii) legjislacion i punës dhe politikat e tregut të punës.
<i>Kuadri institucional dhe koordinimi rreth punësimit të të rinjve</i>	Udhëzon se si të bëhet rishikimi i strukturës institucionale dhe mekanizmave koordinues të saj lidhur me politikat dhe programet e punësimit të të rinjve.
<i>Bashkëpunimi zhvillimor për punësimin e të rinjve</i>	Çon tek identifikimi i iniciativave kryesore të punësimit të të rinjve të ndërmarrja me përkrahjen e donatorëve bilateralë dhe/ose asistencës ndërkombëtare për zhvillim.
Seksioni 2. Përcaktimi i politikave prioritare	
<i>Identifikimi i problemeve dhe analiza e tyre</i>	Identifikon problemet kryesore (bazuar në rezultatet e analizës së situatës) që do të trajtohen nga PKA-ja.
<i>Gjenerimi i opsioneve të politikave</i>	Përshkruan formulimin e politikave prioritare (si vazhdim i problemeve dhe sfidave të identifikuar në seksionet e mëparshme), gjenerimin e opsioneve të politikave, renditjen e tyre si dhe përzgjedhjen përfundimtare.
Seksioni 3. Aksionet e planifikuara	
<i>Qëllimi</i>	Ndihmon të përcaktohet qëllimi i PKA-së dhe lidhjet e saj me kuadrot më të gjerë nacionale për zhvillim
<i>Objektivat dhe synimet e punësimit të të rinjve</i>	Fokusohet në mënyrat e formulimit të objektivave dhe synimeve që duhen arritur pas përfundimit të zbatimit të PKA-së.
<i>Rezultatet dhe treguesit kryesorë operacionalë</i>	Orienton në përcaktimin dhe matjen e rezultateve operacionale që priten të dalin nga zbatimi i PKA-së.
<i>Burimet</i>	Tregon nevojën për të identifikuar burimet njerëzore, materiale dhe financiare, që nevojiten për zbatimin e PKA-së.
<i>Zbatimi dhe mekanizmat koordinues</i>	I referohet mekanizmave që duhen krijuar për zbatimin e PKA-së.
<i>Monitorimi dhe vlerësimi</i>	Çon në sistemin dhe mjetet që duhen përdorur për të monitoruar zbatimin dhe vlerësuar impaktin e PKA-së.
Seksioni 4. Dokumentet që i duhen bashkëngjitur PKA-së	
	Përshkruan dokumentet kryesore që i duhen bashkëngjitur PKA-së.
PJESA III. Paketa e modeleve dhe matricave për PKA-të.	
	Ofron: i) Udhëzime për identifikim të tregut të punës në përgjithësi, ii) modele të matricave, planit të punës dhe projekteve të PKA-së; iii) listën e Normave Ndërkombëtare të Punës relevante për të rinjtë.

PJESA I.

Procesi për përgatitjen e Planit Kombëtar të Aksionit për Punësimin e të Rinjve



1. Para se të angazhohemi në përpilimin e PKA-së

Vendimi për përpilimin e PKA-së duhet të rezultojë nga angazhimi i qëndrueshëm i vendit për avancimin e punësimit të të rinjve. Si i tillë, ai duhet të mbajë parasysh disa kushte.

E para, procesi që mbështet formulimin dhe zbatimin e suksesshëm të PKA-së kërkon përfshirjen e një sërë aktorësh. Kompleksiteti dhe përmasat e çështjes së punësimit të të rinjve në shumicën e vendeve kërkojnë angazhimin e politikëbërësve nga agjencitë e ndryshme qeveritare, të organizatave të punëdhënësve dhe punëmarrësve dhe të institucioneve të tjera të tregut të punës si dhe të përfaqësuesve të grupeve të interesit siç janë shoqatat e të rinjve. Një pjesëmarrje e lartë është thelbësore për të siguruar pronësinë me bazë të gjerë mbi këtë dokument dhe mbështetjen për reformat që synojnë përmirësimin e perspektivave për punësim të të rinjve.

E dyta, si edhe për reformat e tjera, përpilimi i suksesshëm i PKA-së supozon dhënien e rezultateve në afatin e mesëm dhe të gjatë. Për këtë arsye angazhimi i qëndrueshëm kohor është shumë i rëndësishëm për të hyrë në problemet e tregut të punës së të rinjve dhe për të rritur kthimet e investimeve që bëhen për punësimin e tyre.

E treta, përpilimi i PKA-së duhet bazuar në vlerësimin e kujdesshëm dhe realist, nga njëra anë, të problemeve që duhen trajtuar dhe, nga ana tjetër, të burimeve të disponueshme. Për këtë arsye është vendimtare që të identifikohen prioritetet dhe të bëhet dedikimi i burimeve që janë të nevojshme për realizimin e tyre.

Së fundi, një PKA nuk është qëllim në vetvete, porse një mjet për të drejtuar veprimtarinë për punësimin e të rinjve përmes zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të një vargu masash koherente që mbështesin prioritetet e ndryshme politikash. Zakonisht vendet kanë strategji dhe plane të mira, por që dështojnë në zbatim, dhe, për rrjedhojë, kanë pak ose aspak impakt.

2. Fazat e sugjeruara për përpilimin e PKA-së

Një punë e koordinuar dhe bashkërenduar për përpilimin e PKA-së kërkon kontributin e shumë institucioneve dhe agjencive, si dhe një përcaktim të qartë të përgjegjësi dhe roleve të tyre përkatëse. Kutiza 1 ilustron partnerët kombëtar dhe ndërkombëtarë që mund të përfshihen në hartimin e PKA-së.

Procesi i propozuar për hartimin e PKA-së parasheh tri faza kryesore: (1) ngritja e mekanizmit për përpilimin e PKA-së; (2) përgatitja nga vendi dhe nga ENMT-ja e misionit të ENMT-së në vend dhe kryerja e misionit; (3) draftimi i PKA-së dhe puna për plotësimin e draft-dokumentit; dhe (4) puna përfundimtare dhe miratimi i PKA-së. Në vazhdim do të keni të përshkruar hapat që sugjerohen për secilën fazë. Duhet të kihet parasysh se gjatë këtij procesi mund të jetë i nevojshëm shërbimi i përkthimit dhe interpretimit.

Faza 1: Ngritja e mekanizmit për përpilimin e PKA-së

Institucioni Qeveritar Përgjegjës

- ☐ zhvillon konsultime me institucionet relevante e veçanërisht me partnerët socialë me qëllim që të sigurojë angazhimin e plotë të tyre gjatë tërë procesit dhe në vazhdimësi
- ☐ cakton Koordinatorin Kombëtar
- ☐ në vijim të konsultimeve, formon Ekipin Teknik Kombëtar (ETK), që drejtohet nga Koordinatori Kombëtar
- ☐ vendos përmes konsultimeve nëse duhet ftuar ndonjë agjenci ndërkombëtare që të veprojë si Institucion Udhëheqës gjatë përpilimit të PKA-së.

➔ *Nëse është e nevojshme ndihma ndërkombëtare:*

- ☐ përcakton në konsultim me Koordinatorin Kombëtar dhe Institucionin Udhëheqës kohën e vizitës së parë në vend të ENMT-së
- ☐ i dërgon Institucionit Udhëheqës një kërkesë për një mision teknik.

Koordinatori Kombëtar:

- ☐ thërret takimin e parë të ETK-së për të shpjeguar kërkesat për përpilimin e PKA-së

- ☐ kontrakton, kur është e nevojshme dhe në marrëveshje me ETK-së, kryerjen e studimeve teknike për të plotësuar boshllëqet në informacion dhe të dhëna
- ☐ koordinon dhe/ose kontrakton përgatitjen e analizës së situatës.

➔ *Nëse është e nevojshme ndihma ndërkombëtare::*

- ☐ përgatit draft-programin e takimeve për misionin e ENMT-ën, në konsultim me Institucionin Udhëheqës
- ☐ i dërgon ENMT-së materialet dhe informacionet përkatëse, duke përfshirë këtu edhe analizën e situatës.

Nëse është e nevojshme ndihma ndërkombëtare:

Institucioni Udhëheqës:

- ☐ formon një ekip ekspertësh teknikë që do të përbëjnë ENMT-ën dhe që do të koordinohet nga Institucioni Udhëheqës.

Ekipi Ndërkombëtar i Mbështetjes Teknike:

- ☐ vendos kontaktet e para me Koordinatorin Kombëtar për të diskutuar rreth procesit të PKA-së
- ☐ jep udhëzime për përgatitjen e analizës së situatës.

Kutiza 1. Partneriteti për përpilimin e PKA-së.

Siç është përmendur tanimë, përgjegjësia kryesore për përpilimin (dhe zbatimin) e PKA-së mbetet tek institucionet dhe partnerët vendas. Megjithatë dhe në varësi të kushteve të veta, një vend mund të vendosë të përdorë asistencën ndërkombëtare. Në vazhdim do të paraqesim një përmbledhje të shkurtër të institucioneve dhe partnerëve që mund të përfshihen në përpilimin e PKA-së, si dhe rolet dhe përgjegjësitë e tyre përkatëse.

Institucionet dhe partnerët kombëtarë

Institucioni Qeveritar Përgjegjës: institucioni qeveritar që është përgjegjës për të koordinuar hartimin e PKA-së. Zakonisht, këtë përgjegjësi e merr përsipër Ministria e Punës/Punësimit. Mirëpo, varësisht rrethanave në vend, këtë rol do të mund ta mermin edhe Zyra e Kryeministrit apo Zyra e Presidentit.

Ekipi Teknik Kombëtar (ETK): një ekip multi- sektorial ekspertësh teknikë – i caktuar, përmes konsultimesh, nga Institucioni Qeveritar Përgjegjës dhe i drejtuar nga një Koordinator Kombëtar – që drafton PKA-në. ETK-ja nuk duhet të përbëhet nga më shumë se shtatë (7) ekspertë teknikë, nga të cilët së paku njëri duhet të jetë ekspert nga fusha e ekonomisë, punësimit dhe arsimit përkatësisht dhe së paku një zyrtar teknik nga organizatat e punëdhënësve apo ato të punëtorëve (partnerët socialë). Për t'u siguruar që çështjet gjinore pasqyrohen siç duhet në PKA, këshillohet që një nga ekspertët teknikë të ketë njohuri mbi çështjet gjinore (p.sh. personi i kontaktit për çështjet gjinore në Ministrinë e Punës). ETK-ja, nëse është e nevojshme, mund të përfshijë edhe ekspertë nga akademia, institucione të specializuara dhe grupe të rinjsh që do të shërbejnë si persona burimorë për çështje specifike teknike. Në rast se PKA po përpilohet me asistencën e një agjencie ndërkombëtare, ETK-ja do të shërbejë si kundraparti teknik kombëtar për Ekipin Ndërkombëtar të Mbështetjes Teknike.

Koordinatori Kombëtar: personi i caktuar nga Institucioni Qeveritar Përgjegjës të koordinojë ETK-ën Nëse është e përfshirë një agjenci ndërkombëtare, ky person lidhet, në emër të ETK-ës, me Ekipin Ndërkombëtar të Mbështetjes Teknike dhe do të jetë përgjegjës për të koordinuar gjithë përgatitjet, logjistikën dhe vazhdimësinë e vizitës së Ekipit Ndërkombëtar të Mbështetjes Teknike.

Institucionet dhe Partnerët Ndërkombëtarë (nëse janë të përfshirë)

Institucioni Udhëheqës: agjencia ndërkombëtare e ngarkuar të koordinojë Ekipin Ndërkombëtar të Mbështetjes Teknike. Kjo mund të jetë ONP-ja, OKB-ja apo Banka Botërore (si partnerë themelorë të Rrjetit të Punësimit të të Rinjve) apo ndonjë organizatë tjetër ndërkombëtare e caktuar.

Ekipi Ndërkombëtar i Mbështetjes Teknike (ENMT): një ekip ekspertësh ndërkombëtarë i koordinuar nga Institucioni Udhëheqës dhe i përbërë nga staf i agjencive ndërkombëtare të përfshira dhe nga konsulentë (nëse është e nevojshme) që i japin vendit mbështetje teknike për hartimin e Planit Kombëtar të Aksionit.

Partnerët shumëpalësh dhe dypalësh: ONP, Kombet e Bashkuara dhe Banka Botërore, institucione/donorë të tjerë ndërkombëtarë apo dypalësh, dhe Sekretariati i Rrjetit për Punësimin e të Rinjve.

Faza 2: Identifikimi i fokusit kryesor të PKA-së

Koordinatori Kombëtar:

- ☐ thërret dhe kryeson mbledhjet e ETK-ës kur duhen paraqitur konstatimet nga analiza e gjendjes
- ☐ thërret anëtarët e ETK-ës në grupe pune tematike për të thelluar analizën në fusha specifike të politikave
- ☐ përgatit draft-afatet për përfundimin e draft-PKA-së dhe afatet për paraqitjen dhe miratimin e saj tek EKT-ja
- ☐ mban kontakte të vazhdueshme me Institucionin Qeveritar Përgjegjës.

➔ *Nëse përfshihet ndihma ndërkombëtare::*

- ☐ kërkon input teknik nga ENMT-ja lidhur me analizën e gjendjes dhe ia paraqet atë ETK-ës
- ☐ organizon takime dypalëshe mes ENMT-ës dhe institucioneve të ndryshme vendase dhe ndërkombëtare, përfshirë dhe partnerët socialë
- ☐ organizon një workshop një ditor për ETK-ën dhe ENMT-ën për të diskutuar sfidat kryesore për punësimin e të rinjve sikurse dalin nga analiza e gjendjes si dhe fokusin e PKA-së.

Ekipi Teknik Kombëtar:

- ☐ diskuton dhe komenton analizën e situatës
- ☐ anëtarët e ETK-ës marrin pjesë në grupet tematike të punës bazuar në ekspertizën që kanë marrë
- ☐ diskuton dhe miraton afatet për përpilimin e PKA-së të paraqitura nga Koordinatorin Kombëtar.

➔ *Nëse përfshihet ndihma ndërkombëtare::*

- ☐ Merr pjesë në workshopin një ditor me ENMT-ën.

Nëse përfshihet ndihma ndërkombëtare:

Ekipi Ndërkombëtar i Mbështetjes Teknike:

- ☐ përgatit komente mbi analizën e gjendjes dhe ia dërgon ato ETK-ës para se të kryejë misionin
- ☐ bën takime teknike të vëçanta me Institucionin Qeveritar Përgjegjës dhe me institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, duke përfshirë këtu edhe partnerët socialë
- ☐ jep inpute teknike në workshop dhe diskuton hapat vijues të asistencës teknike ndërkombëtare.

Faza 3: Hartimi i draftit të PKA-së

Koordinatori Kombëtar:

- ☐ vepron në cilësinë e sekretariatit të përhershëm të ETK-së gjatë hartimit të PKA-së
- ☐ pasi bie dakort me ETK-ën dhe Institucionin Qeveritar Përgjegjës, shpërndan draftin tek institucionet qeveritare përkatëse në nivel qendror dhe lokal, përfshirë dhe partnerët socialë, dhe mbledh komentet
- ☐ dërgon draftin final të PKA-së tek Institucioni Qeveritar Përgjegjës.

→ *Nëse përfshihet ndihma ndërkombëtare:*

- ☐ dërgon draftin e përfunduar të PKA-së tek Institucioni Udhëheqës për komente përfundimtare
- ☐ koordinon finalizimin e draft-PKA-së në dritën e inputeve nga ENMT-ja
- ☐ dërgon programin e konferencës Kombëtare tripalëshe-plus tek Institucioni Udhëheqës.

Ekipi Teknik Kombëtar

- ☐ diskuton dhe drafton seksionet pasuese të PKA-së (prioritetet e politikave dhe planifikimi i aksioneve, përfshirë matricat dhe skicë-projektet përkatëse)
- ☐ konsolidon draftin në bazë të inputeve të marra përmes Koordinatorit Kombëtar nga partnerë të ndryshëm
- ☐ harton, në bashkëpunim me Institucionin Qeveritar Përgjegjës, një propozim për një konferencë Kombëtare tripalëshe-plus, për të miratuar PKA-në.

→ *Nëse përfshihet ndihma ndërkombëtare:*

Ekipi Ndërkombëtar i Mbështetjes Teknike:

- ☐ rishikon draft-PKA-në dhe i jep inpute dhe komente ETK-ës
- ☐ hyn në dialog me ETK-ën dhe Institucionin Qeveritar Përgjegjës për organizimin e një konferencë Kombëtare tripalëshe-plus.

Faza 4: Miratimi përfundimtar i PKA-së

Institucioni Qeveritar Përgjegjës:

- ☐ organizon konferencën Kombëtare tripalëshe-plus, duke përfshirë në të edhe komunitetin e donatorëve, për të prezantuar dhe miratuar PKA-në
- ☐ përcjell PKA-në tek instanca qeveritare që është përgjegjëse për miratimin e saj
- ☐ kontakton donatorët për të mobilizuar burime ekstra-buxhetore për zbatimin e PKA-së.

Ekipi Teknik Kombëtar:

- ☐ prezanton PKA-në përfundimtare në konferencë
- ☐ pas konferencës, së bashku me Koordinatorin Kombëtar, ngenë mekanizmat monitorues për zbatimin e PKA-së.

PJESA II.

Udhëzime për përpilimin e Planit Kombëtar të Aksionit për Punësimin e të Rinjve



1. Analiza e situatës

Pjesa e parë e PKA-së duhet të përmbajë analizën e punësimit të të rinjve, brenda kuadrit politik dhe institucional ekzistues më të gjerë. Në rastin më të mirë, analiza e situatës duhet të përmbajë informacion mbi tendencat e dhjetë viteve të fundit. Për ndryshimet demografike, periudha duhet më e gjatë. Kjo analizë duhet të përmbajë: një vështrim të dispozitave për të rinjtë në politikat sociale dhe ekonomike; një pasqyrim të plotë të punësimit të të rinjve në tregun e punës; një rishikim të politikave të punësimit dhe të masave të tregut të punës të mëparshme dhe të tanishme që ndikojnë në punësimin e të rinjve; dhe pasqyrimin e kuadrit institucional që drejton tregun e punës së të rinjve si dhe të iniciativave kryesore për punësimin e të rinjve të ndërmarra me mbështetjen e donatorëve dhe/ose komunitetit ndërkombëtar.

Ky veprim synon që të mbështesë politikëbërësit e përfshirë në formulimin e PKA-së të identifikojnë sfidat kryesore, përfshirë pikat e forta dhe të dobta, që duhen trajtuar në analizën e situatës së tanishme. Kjo analizë do të jetë pikënisje për procesin e përpilimit të PKA-së. Ajo përmban informacion kyç mbi problemet kryesore që duhen trajtuar përsa i përket punësimit të të rinjve. Për këtë arsye, ajo është e domosdoshme për të ecur përpara drejt pjesëve të tjera të PKA-së. Siç u përmend edhe më parë, disponueshmëria e informacionit ndryshon nga vendi në vend. Ndaj, një lloj fleksibiliteti është i nevojshëm lidhur me shkallën e detajimit të analizës. Gjithësesi, sugjerohet që struktura e propozuar të ndiqet në gjithë analizën dhe të pasqyrohet në seksionin e parë të PKA-së.

Procesi i mbledhjes dhe analizës së informacionit për të përgatitur pjesën e parë të PKA-së duhet të udhëhiqet nga një numër pyetjesh. Pyetjet kryesore që do të ndihmojnë analizën paraqiten në vijim.

1.1. Vështrim mbi kontekstin ekonomik dhe social

Udhëzime për vështrimin e kontekstit ekonomik e social

QËLLIMI:

Të analizohet se si politikat ekonomike dhe sociale trajtojnë punësimin

DETYRAT:

- ☐ Të jepen treguesit kryesorë makroekonomikë dhe niveli i varfërisë ;
- ☐ Të analizohet përmbledhtazi se si politikat kryesore makroekonomike, planet e reformave, politikat sektoriale dhe iniciativat për zhvillimin e sektorit privat ndikojnë në punësim;
- ☐ Të analizohet se si politikat kryesore sociale, duke përfshirë dhe ato që rregullojnë pabarazitë dhe nxisin përfshirjen sociale, janë të rëndësishme për punësimin;
- ☐ Të formulohen përmbledhtazi problemet kryesore me rëndësi për punësimin që rezultojnë nga analiza e politikave ekonomike e sociale të vendit tuaj.

- ➔ Të sigurohet informacion mbi tendencat e treguesve kryesorë makroekonomikë (p.sh. shkalla e rritjes së PBB-ës, shkalla e inflacionit dhe interesit, gjendja e financave publike, shkalla e këmbimit, balanca e tregtisë së jashtme, investimet e huaja të drejtëpërdrejta) dhe të treguesve të varfërisë (p.sh. përqindja e popullsisë që jeton nën pragun e varfërisë, indeksi i dallimeve të varfërisë, PBB-ja për frymë e vlerësuar në bazë të fuqisë blerëse dhe indeksi Gini).
- ➔ Të analizohet se si politikat kryesore makroekonomike (politikat makroekonomike, tregtare dhe sektoriale) dhe kuadri për stabilizim makroekonomik dhe zhvillim ekonomik (p.sh. Vlerësimi i Përbashkët i Vendit (CCA)² dhe Kuadri i Asistencës për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDAF), strategjitë për uljen e varfërisë, planet e zhvillimit kombëtar) ndikojnë dhe/ose marrin në konsideratë çështjet e punësimit.
- ➔ Të analizohet se si iniciativat kryesore qeveritare për zhvillim të sektorit privat (p.sh. politikat industriale, promovimi i ndërmarrjeve, politikat e investimeve) janë të rëndësishme për krijimin e punësimeve.
- ➔ Të analizohet se si politikat ekzistuese sociale (p.sh. asistenca sociale dhe shërbime të tjera, shëndetësia, strehimi)³ prekin punësimin.

² CCA-ja është instrumenti i sistemit të Kombeve të Bashkuara që analizon situatën e zhvillimit vendas dhe identifikon çështjet kyçe të zhvillimit. UNDAF-i del nga përpjekja analitike dhe bashkëpunuese e CCA-së dhe është baza e programeve për bashkëpunim të sistemit të Kombeve të Bashkuara. Për më shumë informacion, shih www.un.org/special-rep/ohrrls/ohrrls/cca_undaf_prsp.htm

³ Duke parë impaktin domethënës në punësimin e të rinjve, politikat arsimore – zakonisht të grupuara me politikat sociale – nuk do të trajtohen këtu, por do të analizohen me hollësi në Seksionin 1.3.

1.2. Analiza e tregut të punës së të rinjve

Udhëzime mbi analizën e tregut të punës së të rinjve

QËLLIMI:

Të krijohet një pasqyrë e qartë e tregut të punës së të rinjve në vendin tuaj

DETYRAT:

- ☐ Të paraqitet gjendja e përgjithshme e tregut të punës;
- ☐ Të sigurohet informacion i hollësishëm mbi treguesit kryesorë të tregut të punës së të rinjve, të ndarë sipas gjinisë, moshës, gjendjes social-ekonomike, vendndodhjes gjeografike, etj., dhe të analizohen ato;
- ☐ Të formulohen qartazi problemet kryesore me rëndësi për punësimin e të rinjve që dalin nga analiza e tregut të punës së të rinjve në vendin tuaj.

Kjo pjesë e PKA-së duhet të sigurojë një analizë të tregut të punës së të rinjve. Në kushte ideale, një analizë e tillë duhet të paraprihet nga një pasqyrim i gjendjes së përgjithshme të tregut të punës. Në njërën anë, ky pasqyrim mundëson krahasimin e pozitës së të rinjve në tregun e punës në raport me pozitën e të rriturve. Në anën tjetër, aty ku ekzistojnë të dhëna mbi treguesit kryesorë të tregut të punës dhe këto janë të ndara, kryesisht sipas moshës, treguesit e tregut të punës së të rinjve mund të nxirren fare lehtë prej tyre. Informacioni i paraqitur duhet të identifikojë dhe analizojë dallimet gjinore në tregun e punës me qëllim që të pasqyrohen situatat e ndryshme që hasin të rejat dhe të rinjtë në tregun e punës. Mjeti 2 jep udhëzime mbi treguesit për pasqyrimin e gjendjes së përgjithshme në treg të punës për vendet që vendosin të përfshijnë në PKA një pasqyrë të tillë të përgjithshme.

Ekzistenca e informacionit mbi treguesit kryesorë të tregut të punës së të rinjve është kusht i domosdoshëm për identifikimin e veçorive dhe tendencave të sfidës së punësimit të të rinjve në vend (shih Kutizën 2 mbi përshkrimin e treguesve kryesorë të tregut të punës që kanë të bëjnë me punësimin, papunësinë dhe inaktivitetin).⁴ Pra, ky informacion është i domosdoshëm për hartimin e një PKA-je që kërkon të trajtojë me efektivitet problemet që të rinjtë hasin për të gjetur dhe mbajtur një vend pune. Nëse ky informacion nuk është i disponueshëm, përpara përpilimit të PKA-së duhet bërë një studim i tregut të punës së të rinjve për të kapur variablat sasiorë dhe cilësorë që përcaktojnë kalimin dhe pozicionin e të rinjve në botën e punës.⁵

Aty ku është e mundur, të dhënat lidhur me moshën duhet të ndahen në dy grupmosha (adoleshentë 15-19 vjeç dhe të rritur të rinj 20-24 vjeç)⁶ dhe sipas karakteristikave të tjera si gjinia, niveli arsimor, vendndodhja gjeografike (urbane/rurale), origjina etnike dhe aftësitë e kufizuara. Në përgjithësi, disa grupe të rinjsh janë më të disfavorizuar se të tjerët dhe karakteristikat e tyre mund të ndryshojnë nga vendi në vend dhe me kalimin e kohës. Kjo do të thotë se rreziqet dhe mundësitë janë të shpërndara pabarazisht në mes të rinjve dhe, veçanërisht, mes vajzave dhe djemve. Për t'u siguruar që PKA-ja të jetë vërtetë përfshirëse dhe me kosto efektive, është e domosdoshme që në këtë seksion të identifikohen grupet e të rinjve që janë më të disfavorizuar se të tjerët në tregun vendas të punës dhe të vihen në pah arsyet e disavantazhit të tyre (p.sh. prejardhja social-ekonomike, niveli arsimor, vendndodhja gjeografike, diskriminimi në treg të punës si pasojë e gjinisë, originës etnike, gjendjes shëndetësore apo religionit të tyre). Një disavantazh i tillë priret t'i vërë ata në rrezik më të madh përjashtimi social. Kështu, kjo analizë është e

⁴ Ky informacion zakonisht ofrohet nga Studimi i Fuqisë Punëtore (SFP), ose në mënyrë alternative, nga të dhënat administrative të Ministrisë së Punës dhe/ose shërbimeve të punësimit. Lidhur me papunësinë, nëse të dhënat vijnë nga të dhëna administrative, duhet përmendur që përqinda e papunësisë i referohet "papunësisë së regjistruar". Ndërkohë, në vendet ku nuk ka të dhëna nga SFP-e dhe burime administrative të besueshme, informacioni mund të nxirret nga studimet e kryera për familjet apo për matjen e standartit të jetesës.

⁵ ONP-ja ka përpiluar një mjet statistikor për t'i ndihmuar vendet të përmirësojnë hartimin e politikave dhe programeve për punësimin e të rinjve. Ky mjet, i quajtur Studim i Kalimit nga Shkolla në Punë, përmban shumicën e treguesve të listuar në Seksionin 1.2. Informacion lidhur me këtë mjet mund të gjendet në: <http://www.ilo.org/youth/swts.htm>

⁶ Përkufizimi standart i Kombeve të Bashkuara quan të rinj ata persona që janë mes moshës 15-24 vjeç. Gjithësesi, përkufizimet për të rinjtë mund të ndryshojnë nga një vend në tjetrin. Në këtë pjesë të PKA-së duhet regruar qartë përkufizimi i vendit dhe

rëndësishme për të përcaktuar cënueshmëritë që mund të kërkojnë ndërhyrje specifike për parandalimin dhe/ose zgjidhjen e problemeve në fjalë. Sa më i saktë të jetë informacioni, aq më e mirë do të jetë analiza dhe aq më të mëdha gjasat që ndërhyrjet t'i përgjigjen me sukses nevojave të grupeve të caktuara, sidomos të rinjve në rrezik.⁷

Thënë më saktësisht, analiza e tregut të punës së të rinjve duhet të fokusohet në këta tregues:

Popullsia

- *Tendencat demografike* sipas gjinisë dhe moshës [fëmijët (0-14) dhe grupmoshat e të rinjve] dhe projeksioneve, përfshirë përqindjen e lindshmërisë si dhe përqindjen e fëmijëve dhe të të moshuarve në ngarkim.

Arsimi

- *Tendencat në arsim* – ndjekja e arsimit, numri i nxënësve në shkollim, numri i braktisjeve të shkollës, përqindja e regjistrimit dhe lexim-shkrimit – sipas gjinisë, moshës [fëmijë (0-14) dhe grupmoshat e të rinjve] dhe aty ku është e mundur, sipas grupeve të cënueshme (p.sh. grupe etnike, të rinj me aftësi të kufizuara, HIV-AIDS, punëtorë migrantë).

Fuqia punëtore

- *Pjesëmarrja e të rinjve në fuqinë punëtore* gjatë dekadës së kaluar e ndarë sipas grupmoshave të të rinjve, gjinisë, nivelit arsimor dhe rural/urban.
- *Tendencat e punësimit të të rinjve* – përqindja e punësimit, punësimi sipas sektorit ekonomik dhe statusit, në sektorin publik apo privat, sipas orëve të punës (përfshirë punën me kohë të pjesshme me dëshirë apo pa dëshirë) - të ndara sipas grupmoshave të të rinjve, gjinisë, nivelit arsimor dhe rural/urban.
- *Punësimi sipas llojit të kontratës* (me kohë të plotë dhe të pjesshme, të përhershme dhe të përkohshme) dhe statusit në punën kryesore (punëtorë me rrogë e pagë, punëtorë të vetëpunësuar, punëtorë anëtarë të familjes) sipas grupmoshave të të rinjve, gjinisë dhe urban/rural. Kur është e mundur, informacioni duhet të jepet sipas sektorit ekonomik.
- *Punësimi informal* sipas grupmoshave të të rinjve, gjinisë, nivelit arsimor dhe urban/rural. Kur është e mundur, informacioni duhet të jepet sipas sektorit ekonomik dhe statusit të punësimit.
- *Punësimi jo i plotë përsa i përkët kohës*⁸ sipas grupmoshave të të rinjve, gjinisë, nivelit arsimor dhe urban/rural. Kur është e mundur, informacioni duhet të jepet sipas sektorit ekonomik dhe statusit të punësimit.

⁷ Koncepti i të rinjve në rrezik përdoret këtu për të treguar të rinjtë që, për shkak të disa problemeve, (si p.sh. papunësia afatgjatë, abuzimi me drogat, kriminaliteti i moshave të reja) ka të ngjarë të përjashtohen nga shoqëria.

⁸ Punësimi jo i plotë nënkupton përdorimin jo të plotë të fuqisë punëtore, dhe është përdorur për të treguar çdo lloj punësimi të perceptuar nga punëtorët si “të pakënaqshëm” për shkak të orëve të pamjaftueshme (punësimi jo i plotë lidhur me kohën), apo kompensimit të pamjaftueshëm (punësimi jo i plotë që lidhet me të ardhurat) ose përdorimit jo të plotë të aftësive të dikujt (punësimi jo i plotë që lidhet me aftësitë). Deri më sot, punësimi jo i plotë lidhur me kohën është i vetmi komponent i punësimit jo të plotë për të cilin është rënë dakort dhe është bërë përkufizimi i duhur për qëllime matjeje brenda komunitetit ndërkombëtar të statisticienëve të punës. Shih Rezolutën mbi matjen e punësimit jo të plotë dhe të situatave të punësimit jo adekuat, të adoptuar në Konferencën e 16-të Ndërkombëtare të Statisticienëve të Punës, Gjenevë, 1988 në www.ilo.org/public/english/bureau/stat/download/res/underemp.pdf

- *Tendencat e papunësisë së të rinjve* sipas grupmoshave të të rinjve, gjinisë, nivelit arsimor dhe rural/urban. Kur është e mundur, informacioni duhet ndarë sipas kohëzgjatjes, sidomos për papunësinë afatgjatë (> 12 muaj).
- *Raporti i të rinjve në raportin e papunësisë së përgjithshme* (pjesa që zë përqindja e papunësisë së të rinjve në përqindjen e papunësisë së përgjithshme).
- *Raporti i të rinjve në raportin e papunësisë së të rriturve* (pjesa që zë përqindja e papunësisë së të rinjve në përqindjen e papunësisë së të rriturve).

Inaktiviteti

- *Përqindja e inaktivitetit dhe dekurajimit* sipas grupmoshave të të rinjve, gjinisë, nivelit arsimor dhe urban/rural. Nëse është e mundur, duhëndhënë arsyet e inaktivitetit për të kapur dekurajimin e punëtorëve.

Kutiza 2. Treguesit e tregut të punës dhe përkufizimet

Tipari kryesor i treguesve të tregut të punës është se individët klasifikohen në tri kategori reciprokisht përjashtuese të njëra-tjetrës: i/e punësuar, i/e papunë, dhe jo aktiv/e. Sipas kriterëve të përcaktuara nga ONP-ja, përparësi i është dhënë punësimit ndaj papunësisë, dhe papunësisë ndaj inaktivitetit.

Punësimi: kategoria e punësimit përfshin të gjithë ata të cilët, gjatë periudhës së referimit, kanë punuar për një pagë ose pagesë, për përfitim apo fitim të familjes (të vetëpunësuarit apo punëtorët që punojnë për llogarinë e vet) duke përfshirë anëtarët e kooperativave dhe punëtorët familjarë pa pagesë. Treguesit që përdoren për matjen e punësimit janë përqindja e punësimit, domethënë përqindja e njerëzve të punësuar në fuqinë punëtore dhe raporti i punësimit, domethënë pjesa e njerëzve që punojnë nga totali i popullsisë në moshë pune.

Papunësia: kriteret e ONP-së klasifikojnë si “të papunë” të gjithë individët që janë : a) pa punë (nuk marrin pagë ose nuk janë të vetëpunësuar); b) aktualisht të gatshëm për punësim me pagesë apo vetëpunësim , dhe c) duke kërkuar aktivisht punë. Përkufizimi “i relaksuar” i papunësisë heq dorë nga kërkesa për kërkim aktiv të punës, për të përfshirë tek të papunët punëtorët e dekurajuar, domethënë ata individë që nuk kanë qenë duke kërkuar punë sepse mendojnë se nuk ka punë, ose besojnë se nuk kanë aftësitë e duhura për të konkuruar në tregun e punës. Normalisht, punëtorët e dekurajuar nuk përfshihen në llogarinë e papunësisë, por konsiderohen “jo aktivë”. Dy tregues përdoren përtë matur papunësinë: përqindja e papunësisë, që nënkupton pjesën e të papunëve në totalin e fuqisë punëtore dhe raporti i papunësisë, domethënë pjesa e personave që nuk punojnë, janë të gatshëm për punë dhe kërkojnë në mënyrë aktive punë, në popullsinë në moshë pune.

Inaktiviteti i referohet të gjithë atyre personave në moshë pune që nuk janë as të punësuar e as të papunë, domethënë ata të cilët nuk janë “ekonomikisht aktivë”, sepse janë duke ndjekur shkollën, janë të angazhuar në punët e shtëpisë, janë në pension, etj.

Burimi: V. Corbanese dhe G. Rosas: Tranzicioni i të rinjve në punë të denjë: Evidencë nga Kosova, ONP, Gjenevë, 2007 nga R. Hussmans, F Merhan, V.Verma, Studim i popullsisë ekonomikisht aktive, punësimit, papunësisë dhe punësimit jo të plotë: një manual i ONP-së mbi konceptet dhe metodat, ONP, Gjenevë, 1990.

Pagat dhe kushtet e punës

- *Pagat dhe të ardhurat* sipas sektorit dhe profesionit të ndara sipas grupmoshave të të rinjve, gjinisë, nivelit arsimor dhe rural/urban.
- *Siguria dhe shëndeti në punë* – numri i sëmundjeve të shkaktuara nga puna, vdekjeve të shkaktuara nga sëmundjet në punë, aksidenteve fatale e jo fatale, numri i aksidenteve që shkaktojnë mungesë prej 3 apo më shumë ditësh në punë – sipas sektorit dhe gjinisë (nëse është e mundur).
- *Puna e fëmijëve* – numri i të rinjve të moshës 15-17 vjeç në format më të këqija të punës së fëmijëve⁹ sipas gjinisë dhe sektorit.

1.3. Rishikimi i politikave dhe programeve ekzistuese që prekin punësimin e të rinjve

Rishikimi i politikave dhe programeve ekzistuese që nxisin punësimin e të rinjve është hap kryesor për vendet që kanë marrë përsipër të zhvillojnë dhe zbatojnë PKA-në. Pa u shkëputur nga analiza e kuadrit të gjerë makroekonomik dhe efektit të tij në punësim të shpjeguar në Seksionin 1.1, ky seksion do të përqendrohet veçanërisht në politikat dhe programet që ndikojnë në punësimin e të rinjve. Kjo analizë mund të udhëhiqet nga pyetjet e mëposhtme:

Kuadri i përgjithshëm i politikave

Udhëzime për rishikimin e politikave

QËLLIMI:

Të identifikohet se si politikat ekonomike dhe sociale reflektojnë punësimin e të rinjve

DETYRAT:

- ☐ Të identifikohen dhe analizohen dispozitat lidhur me punësimin e të rinjve që janë të përfshira në planet dhe strategjitë kombëtare të zhvillimit;*
- ☐ Të identifikohen dhe analizohen dispozitat e punësimit të të rinjve të përfshira në politikat sektoriale;
- ☐ Nëse vendi juaj ka një politikë të zhvillimit të të rinjve, jepni informacion mbi dispozitat lidhur me punësimin e të rinjve;
- ☐ Të përshkruhet se si politikat sociale ekzistuese prekin punësimin e të rinjve;
- ☐ Të vlerësohet deri ku kanë punuar këto politika për të përmirësuar të perspektivat e punësimit të të rinjve;
- ☐ Të formulohen përmbledhtazi problemet kryesore me rëndësi për punësimin e të rinjve që dalin nga rishikimi i politikave të vendit tuaj.

*Nëse planet dhe/ose strategjitë nuk përmbajnë dispozita specifike për të rinjtë dhe punësimin e të rinjve, analiza duhet të vërejtë në pah se si e prekin punësimin e të rinjve planet dhe strategjitë në fjalë.

- A ka vendi juaj një plan/strategji të zhvillimit kombëtar? Nëse po, cilat janë dispozitat që ndikojnë tek të rinjtë, veçanërisht tek punësimi i të rinjve?

⁹ Shih Konventën (Nr.182), Format më të Këqija të Punës së Fëmijëve, 1999

- ➔ Nëse vendi juaj ka një Strategji të Reduktimit të Varfërisë apo/dhe është i përfshirë në CCA/UNDAF (sikurse përshkruhen në seksionin 1.1) cilat janë dispozitat që ndikojnë te të rinjtë, veçanërisht te punësimi i të rinjve?
- ➔ A përmbajnë politikat sektoriale ekzistuese dhe masat përkatëse (p.sh. incentivat fiskale, zhvillimi i infrastrukturës) dispozita të veçanta për nxitjen e punësimit të të rinjve? Nëse po, përshkruajini.
- ➔ A ka vendi juaj politikë të zhvillimit të të rinjve? Nëse po, cilat janë dispozitat për punësimin e të rinjve?
- ➔ A e mbajnë parasysh politikat ekzistuese sociale (p.sh. shëndetësia, strehimi) punësimin e të rinjve? Nëse po, përshkruajini.

Punësimi dhe tregu i punës

Udhëzime për rishikimin e strategjive të punësimit dhe informacionit të tregut të punës

QËLLIMI:

Të identifikohet deri ku trajtohet punësimi i të rinjve në strategjitë e punësimit dhe informacionin e tregut të punës

DETYRAT

- ☐ Nëse vendi juaj ka një strategji punësimi, identifikoni dhe analizoni komponentët kryesorë të punësimit të të rinjve dhe synimet që duhen arritur;
- ☐ Vlerësoni deri ku kjo strategji përmirëson perspektivat e punësimit të të rinjve;
- ☐ Përshkruani anët e forta dhe të dobta të sistemit të informacionit të tregut të punës dhe vlerësoni sa lidhet ai me punësimin e të rinjve;
- ☐ Formuloni përmbledhtazi problemet kryesore që dalin nga analiza e strategjisë së punësimit dhe informacionit të tregut të punës në vendin tuaj.

- ➔ A ka vendi juaj një strategji punësimi? Nëse po, cilët janë komponentët kryesorë që trajtojnë punësimin e të rinjve?
- ➔ Si mblidhet Informacioni i Tregut të Punës (ITP) dhe si është i organizuar sistemi (p.sh. përmes anketimeve të familjeve dhe subjekteve, regjistrimit të popullsisë, të dhënave administrative)? A përmban ITP tregues specifikë për punësimin e të rinjve? A kryen vendi juaj studim të fuqisë punëtore? Ky studim a kryhet rregullisht?

Arsimi dhe formimi:

Udhëzime për rishikim të sistemit të arsimit dhe formimit

QËLLIMI:

Të kuptohen dhe analizohen veçoritë kryesore të politikës dhe sistemit të arsimit e formimit si dhe ndikimi i tyre në punësimin e të rinjve

DETYRAT:

- ☐ Të analizohen elementet kryesore të politikave dhe sistemit të arsimit, përfshirë dhe arsimin e mesëm dhe terciar;
- ☐ Të analizohen veçoritë kryesore të arsimit dhe formimit profesional dhe vlefshmëria e tyre në raport me kërkesat e tregut të punës;
- ☐ Të analizohen masat kryesore që kanë të bëjnë me formimin e të rinjve të papunë për treg të punës dhe formim për ndërmarrësi të punëtorëve të rinj;
- ☐ Të identifikohen dhe analizohen masat për rritjen e punësueshmërisë së të rinjve të disfavorizuar dhe të tregohet fushëveprimi i tyre dhe ecuria në kohë;
- ☐ Të vlerësohet roli dhe përfshirja e partnerëve socialë në iniciativat e cekura më lart;
- ☐ Të formulohen përmblendhtazi problemet kryesore të punësimit të të rinjve që dalin nga analiza e sistemit të arsimit dhe formimit në vendin tuaj.

- ➔ Jepni një vështrim të karakteristikave kryesore të politikave dhe sistemit të arsimit (p.sh. numri i viteve të nevojshme për secilin nivel të arsimit, mënyrat e ndryshme të arsimit).¹⁰
- ➔ *Parashkollimi*: Cilat janë masat për nxitjen e hyrjes së fëmijëve në institucionet parashkollore në fshatra dhe qytete?
- ➔ *Arsimi elementar*: Cilat janë elementet kryesore të politikave dhe sistemit të arsimit? Ç'masa ka marrë Qeveria për të nxitur hyrjen e përgjithshme në arsimin elementar? A ka nisma të veçanta për të reduktuar braktisjet e shkollës (sidomos për vajzat dhe të rejtat) dhe për të kapërcyer pabarazitë për hyrjen në arsimin fillestar? Ç'masa janë marrë për të rregulluar dështimet e arsimit fillestar, përfshirë këtu edhe braktisjet? Si ofrohet orientimi për arsim nëpër shkolla nga fundi i arsimit elementar?
- ➔ *Arsimi më i lartë*: Cilat janë veçoritë kryesore të arsimit të mesëm dhe atij terciar? Në ç'mënyrë politikat e arsimit më të lartë marrin në konsideratë projeksionet e tregut të punës? Deri në ç'masë sistemi i arsimit më të lartë përputhet me mundësitë e punësimit që ekzistojnë për të diplomuarit e rinj që përfundojnë studimet?
- ➔ *Arsimi dhe formimi profesional fillestar*: Cilët janë elementët kryesorë të politikave dhe sistemit të arsimit dhe formimit profesional (AFP)? Cilat janë masat për përmirësimin e qasjes së të rinjve në formimin fillestar? Në ç'masë programet e formimit ofrojnë përvojë pune (p.sh. periudhë trajnimi në ndërmarrje, kontrata pune për trajnim, stazh, çirakëri, mësim)? Ç'mekanizma ekzistojnë për nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të AFP-së dhe ndërmarrjeve? Sa i përgjigjen aftësive e ofruara kërkesave të tregut të punës?¹¹ Si përfshihen shërbimet e këshillimit për punësim në dhënien e trajnimit?
- ➔ *Mësimi i vazhdueshëm*: Cilat janë masat e Qeverisë për (ri)-formimin e të rinjve të papunë? Ç'masa nxisin ndërmarrjet të formojnë punëtorë të rinj dhe të përmirësojnë kushtet e tyre të punës?

¹⁰ Shih Mjetin 4 lidhur me përshkrimin e niveleve të ndryshme të arsimit sipas klasifikimit standart ndërkombëtar të arsimit (ISCED 1997) bërë nga UNESCO 1997.

¹¹ Jepni informacion lidhur me eficientësin e jashtme të trajnimeve, domethënë, përqindjen e të trajnuarë që kanë gjetur punë në profesionin për të cilin janë trajnuar.

- ➔ *Financimi i arsimit dhe formimit:* Sa është investimi publik për arsimin dhe formimin si përqindje e PBB-ës? Cila ka qenë tendenca në 10 vitet e fundit? Cilët janë mekanizmat e financimit të AFP-ës dhe mësimi të vazhdueshëm, cilët janë kontribuesit kryesorë dhe pjesët përkatëse të financimit?
- ➔ *Barazia dhe qasja:* Cilat janë masat për nxitjen e qasjes së barabartë të të rejave dhe të rinjve (si në zonat urbane ashtu dhe në ato rurale) në politikat dhe programet e arsimit dhe të AFP-ës? Ç'masa specifike janë miratuar për të evituar stereotipat gjinore në arsim dhe formim? Cilat janë masat e dizajnuara për grupe specifike të rinjsh të disfavorizuar (p.sh. të rinj që dinë pak lexim dhe shkrim)? Në ç'masë këto politika dhe programe njohin dhe trajtojnë diskriminimin në punësim dhe profesion? A janë këto masa të posaçme (ad-hoc) apo të dizajnuara për të mbështetur angazhime afatgjata?
- ➔ *Dialogu social:* Si përfshihen organizatat e punëdhënësve dhe punëmarresve në formulimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve të AFP-ës?

Zhvillimi i ndërmarrjeve:

Udhëzime për rishikim të politikave dhe programeve për zhvillim të ndërmarrjeve

QËLLIMI:

Të vlerësohet kapaciteti i sektorit të ndërmarrjeve për krijim të vendeve të reja të punës për të rinjtë

DETYRAT:

- ☐ Të analizohet shkurtimisht se si politikat për mjedisin e biznesit dhe nxitjen e ndërmarrjeve ndikojnë në punësimin e të rinjve;
- ☐ Të vlerësohen anët e forta dhe të dobta të politikave dhe programeve ekzistuese për të nxitur sipërmarrjen dhe vetëpunësimin e të rinjve;
- ☐ Të analizohet se si masat e marra për të lehtësuar regjistrimin e mikro-ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla që veprojnë në sektorin informal kanë ndikim në punësimin e të rinjve;
- ☐ Të analizohen masat për rritjen e punësimit me pagë dhe vetëpunësimin për të rinjtë e disfavorizuar dhe të tregohet fushëveprimi dhe evolimi i tyre me kalimin e kohës;
- ☐ Të vlerësohet roli dhe përfshirja e partnerëve socialë në iniciativat e përmendura më lart;
- ☐ Të formulohen përmbledhtazi problemet kryesore për punësimin e të rinjve që dalin nga analiza e politikave dhe programeve të zhvillimit të ndërmarrjeve në vendin tuaj.

- ➔ *Mjedisi i biznesit dhe zhvillimi i ndërmarrjeve:* Cilat janë veçoritë kryesore të politikave që ndikojnë në mjedisin e biznesit? Cilat janë masat për nxitjen e mikro-ndërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, përfshirë dhe kooperativat? Cilat janë masat që lehtësojnë regjistrimin e ndërmarrjeve që veprojnë në ekonominë informale? Përshkruani se si këto politika ndikojnë në perspektivat e punësimit për të rinjtë dhe të rejtat.
- ➔ *Vetëpunësimi dhe sipërmarrja e të rinjve:* Cilat janë politikat dhe programet që nxisin sipërmarrjen për të rinjtë (vetëpunësimi dhe sipërmarrja në grup)? Cilët janë aktorët kryesorë të përfshirë në zbatimin

e këtyre programeve (p.sh. agjencitë qeveritare, organizatat e punëdhënësve, sektori privat, organizatat joqeveritare)? Cilat janë stimulimet dhe shërbimet mbështetëse (p.sh. shërbime financiare e jofinanciare) në dispozicion të sipërmarrësve të rinj? Si ndikojnë këto politika dhe masa në vendimet e të rinjve për t'u angazhuar në sipërmarrje dhe vetëpunësim?

- ➔ *Barazia dhe qasja*: Si kontribuojnë masat për zhvillimin e ndërmarrjeve dhe të sipërmarrjes në përmirësimin e qasjes dhe barazisë së të rinjve në treg të punës, sidomos për ata që përket grave të reja? Cilat janë masat për të nxitur qasjen në punësim tek sektori privat të të rinjve të disfavorizuar? Këto masa a janë të posaçme (ad-hoc) apo janë hartuar për të mbështetur angazhime afatgjata?
- ➔ *Dialogu social*: Si përfshihen organizatat e punëdhënësve dhe punëtorëve në formulimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve që zhvillojnë ndërmarrjet për të nxitur punësimin e të rinjve?

Legjislacioni i punës dhe politikave të programet e tregut të punës

Udhëzime për rishikim të politikave dhe programeve të tregut të punës (1)

QËLLIMI:

Të analizohet se si legjislacioni i punës dhe politikave të pagave ndikojnë në punësimin e të rinjve

DETYRAT:

- ☐ Të përshkruhet se si legjislacioni i punës, përfshirë atë mbi marrjen në punë dhe largimin nga puna, ndikojnë në punësimin e të rinjve;
- ☐ Të përshkruhet se si politikave të pagave ndikojnë në punësimin e të rinjve;
- ☐ Të formulohen përmbledhtazi problemet kryesore të punësimit të të rinjve që dalin nga analiza e legjislacionit të punës dhe e politikave të pagave në vendin tuaj.

- ➔ *Legjislacioni i punës*: Cilët janë mekanizmat që sigurojnë zbatimin e standarteve themelore të punës?¹² Cila është mosha minimale për punë e përcaktuar me ligj? Cilat janë ligjet që parashikojnë mbrojtje të veçantë për punëtorët e rinj me moshë 15 – 17 vjeç? Ç'masa janë marrë për të siguruar që kushtet e punës së të rinjve të përkojnë me legjislacionin kombëtar? Si ndikojnë aktet ligjore të marrjes në punë dhe të largimit nga puna në punësimin e të rinjve, përfshirë edhe ligjet që synojnë reduktimin e kostove të largimit nga puna apo të të drejtave/përfitimeve sociale të punëtorëve të rinj? Cilat janë normat që rregullojnë punën e përkohshme dhe si ndikojnë ato në punësimin e të rinjve? Cilat janë aktet ligjore që nxisin kalimin e punëtorëve informalë në ekonominë formale? Si ndikojnë këto masa tek të rinjtë punëtorë?
- ➔ *Politikave të pagave*: A ka vendi juaj pagë minimale? Po paga për të rinjtë? Si ndikon politika e pagave tek punëtorët e rinj në sektorë të ndryshëm? A marrin burrat dhe gratë shpërblim të barabartë për punë të njëjtë ose në thelb të ngjashme?¹³ Ju lutemi përshkruani.

¹² Një listë e Normave Ndërkombëtare të Punës që lidhen me punën dhe të rinjtë është paraqitur në Mjetin 10 të këtij Udhëzimi, për referencë më të lehtë.

¹³ Konventa (Nr. 100) për Shpërblim të Barabartë dhe Rekomandimi (Nr. 90), të dy të miratuar më 1951, i referohen në mënyrë më specifike eliminimit të diskriminimit në mes punëtorëve femra dhe meshkuj për ata që përket shpërblimit: ato apelojnë për pagesë të barabartë të burrave dhe grave për punë me vlerë të njëjtë.

- *Stimulimet për marrjen në punë:* Cilat janë stimulimet e Qeverisë (p.sh. taksat apo përfitimet e sigurimeve shoqërore për të sapopunësuarit) që nxisin punësimin e të rinjve duke reduktuar koston e punës? Si e nxisin këto masa krijimin e punësimit të qëndrueshëm për të rinjtë?

- *Masat Aktive të Tregut të Punës*¹⁴

Udhëzime për rishikim të politikave dhe programeve të tregut të punës (2)

QËLLIMI:

Të analizohet se si masat aktive të tregut të punës ndikojnë në punësimin e të rinjve

DETYRAT:

- ☐ Të identifikohen dhe analizohen elementët kryesorë dhe renditja e PATP-ve dhe lidhja e tyre me punësimin e të rinjve;
- ☐ Të rishikohen mekanizmat e përcaktimit të synimeve të këtyre masave, sidomos sa i përket të rinjve;
- ☐ Të analizohet kuadri institucional për hartim, monitorim dhe vlerësim të PATP-ve;
- ☐ Të identifikohen dhe përmbledhen veçoritë kryesore të sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të këtyre masave;
- ☐ Të analizohen shkurtimisht anët e forta dhe të dobta të PATP-ve dhe efekti i këtyre në punësimin e të rinjve;
- ☐ Të formulohen përmbledhtazi problemet kryesore për punësimin e të rinjve që dalin nga analiza e masave aktive të tregut të punës në vendin tuaj.

¹⁴ Politikat dhe programet aktive të tregut të punës (PATP) sigurojnë zëvendësim të të ardhurave për punëkërkuar dhe integrim të tyre në treg të punës (punëkërkuar zakonisht janë të papunët, por edhe jo-plotësisht të punësuarit apo individët e punësuar që kërkojnë punë më të mirë). PATP-ët zakonisht përfshijnë shërbimet e punësimit dhe formimit (asistencë për kërkim të punës, përputhje të kërkesës për punë me vendet e lira, informacion mbi tregun e punës; formim dhe riformim) dhe masat për krijimin e vendeve të punës (si punët publike, shërbimet komunitare, krijimi i ndërmarrjeve, vetëpunësimi, subvencionet për punësim për grupe të caktuara të popullsisë).

¹⁵ Këto shtrembërime mund të identifikohen si *firo* (i njëjti rezultat do të ishte arritur edhe pa programin), *efekte zëvendësimi* (pjesëmarrësit e subvencionuar mund të zëvendësojnë jo-pjesëmarrësit), *zhvendosje* (rezultati i aktiviteteve të subvencionuara mund të zhvendosë atë të jo-subvencionuarave) dhe *marrja e ajkës* (kur programet ndihmojnë ata që i kanë punët më mirë).

- Cilët janë elementët kryesorë të politikave dhe programeve aktive të tregut të punës (PATP) në vend (p.sh. formimi për treg pune; orientimi në karrierë, asistencë për të kërkar punë dhe programet e ndërmjetësimit në punë; informacioni i tregut të punës; punët publike dhe shërbimet komunitare; subvencionimet për punësim dhe skemat e tjera të vendosjes në punë; programet e sipërmarrjes)? Cila është renditja me të cilën këto elementë i ofrohen pjesëmarrësve?

- A ka PATP-ë specifike për të rinjtë ose a janë këta të fundit të pranuar tek grupet përfituese? Këto masa i përfshijnë të rinjtë vetëm në bazë të moshës apo marrin në konsideratë nevojat dhe çënueshmërinë e tyre (p.sh. nivelin e ulët arsimor dhe profesional, përkatësinë social-ekonomike, përkatësinë etnike, rrezikun)? A janë PATP-ët të ndjeshme ndaj aspekteve gjinore?

- Si po përfitojnë të rinjtë nga programet aktive të tregut të punës (p.sh. numri i pjesëmarrësve sipas gjinisë dhe grupit; numri i braktisjeve; shpenzimet masat për të rinjtë si përqindje e PBB-ës)? Cilët grupe të rinjsh duket se po përfitojnë më shumë? Të rehat dhe të rinjtë a marrin pjesë barazisht në PATP-ë?

- Çfarë mekanizmash ka për monitorimin e këtyre programeve (p.sh. mbledhje të dhënash)? A është bërë ndonjë vlerësim i efektit të programeve aktive të tregut të punës? Cili është efekti në aspektin e punësimit dhe të ardhurave të të rinjve (jepni informacion mbi rezultatet në treg të punës të grupeve të ndryshme të pjesëmarrësve)? Cilat janë programet apo elementët që funksionojnë më mirë (dhe për cilin grup të rinjsh) në aspektin e kosto-përfitimeve? Cilat janë shtrembërimet, nëse ka, të prodhuara nga PATP-ët?¹⁵

Udhëzime për rishikim të politikave dhe programeve të tregut të punës (3)

QËLLIMI:

Të vlerësohet deri ku të rinjtë përfitojnë nga masat e papunësisë dhe asistencës sociale

DETYRAT:

- ☐ Të tregohen kriteret e përfitimit dhe shtrirja e pagesës së papunësisë dhe asistencës sociale për të rinjtë;
- ☐ Të analizohet kuadri institucional për hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e këtyre masave;
- ☐ Të vlerësohen anët e forta dhe të dobta të këtyre dy grupe masash;
- ☐ Të formulohen përmbledhtazi problemet kryesore për punësimin e të rinjve që dalin nga analiza e masave pasive të tregut të punës në vendin tuaj.

- ➔ Cilat janë kriteret për të përfituar pagesën e papunësisë të rinjtë e papunë dhe asistencën sociale të rinjtë? A është pagesa e papunësisë për të rinjtë më e ulët se për popullsinë e rritur?
- ➔ Si paraqiten faktikisht niveli, shtrirja dhe kohëzgjatja e pagesës së papunësisë dhe përkrahjes sociale për të rinjtë (p.sh. niveli mesatar i pagesës së papunësisë - si përqindje e pagës mesatare – dhe e përkrahjes sociale; përqindja e përfituesve faktikë kundrejt atyre potencialë; shpenzimet për politikën pasive të tregut të punës si përqindje e PBB-ës)?
- ➔ Në ç'masë përfitimet ekzistuese të papunësisë dhe asistencës sociale inkurajojnë apo dekurajojnë të rinjtë që të hyjnë në punë të re? Si lidhen këto përfitime me masat aktive të tregut të punës?

Udhëzime për rishikim të politikave dhe programeve të tregut të punës (4)

QËLLIMI:

Të vlerësohet se në ç'masë çështjet e barazisë reflektohen në politikën dhe programet e tregut të punës dhe në ç'masë partnerët socialë përfshihen në formulimin dhe zbatimin e tyre.

DETYRAT:

- ☐ Të analizohet se si gjithë politikën dhe programet e përmendura më lart kontribuojnë në përmirësimin e qasjes dhe barazisë në tregun e punës së të rinjve;
- ☐ Të vlerësohet roli i partnerëve socialë në formulimin dhe zbatimin si dhe në monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe programeve të cekura më lart;
- ☐ Të vlerësohet fushëveprimi dhe evoluimi në kohë i programeve të tregut të punës për të rinjtë;
- ☐ Të formulohen përmbledhtazi problemet kryesore për punësimin e të rinjve që dalin nga analiza e programeve të tregut të punës në vendin tuaj.

- ➔ *Barazia dhe qasja*: Në ç'mënyrë masat e cekura më lart kontribuojnë në përmirësimin e qasjes dhe barazisë në tregun e punës së të rinjve, sidomos sa i përket barazisë gjinore? Cilat janë masat e hartuara për të nxitur punësimin e të rinjve të disfavorizuar? Deri ku këto masa janë të posaçme (ad-hoc) apo janë hartuar për të mbështetur angazhime afatgjata?
- ➔ *Dialogu social*: Si përfshihen organizatat e punëdhënësve dhe punëtorëve në formulimin dhe zbatimin si dhe në monitorimin dhe vlerësimin e këtyre politikave dhe programeve?

¹⁶ Masa pasive të tregut të punës janë ato që sigurojnë zëvendësim të të ardhurave gjatë kohës së papunësisë apo kërkimit të punës. Këtu zakonisht përfshihen përfitimet e papunësisë dhe masat për pension të parakohshëm.

1.4. Kuadri institucional dhe koordinimi i punësimit të të rinjve

Ky seksion jep orientime se si të rishikohen kuadri institucional dhe mekanizmat koordinues të politikave dhe programeve të punësimit të të rinjve.

Udhëzime për paraqitjen e kuadrit institucional dhe mekanizmit koordinues

QËLLIMI:

Të identifikohen dhe analizohen veçoritë kryesore të kuadrit institucional dhe mekanizmit koordinues të punësimit të të rinjve

DETYRAT:

- ☐ Të analizohen roli dhe përgjegjësitë e institucioneve qeveritare të përfshira në punësimin e të rinjve në nivel kombëtar e lokal, duke përfshirë dhe mekanizmat koordinues, si dhe të tregohen anët e forta dhe të dobta;
- ☐ Të vlerësohen roli dhe funksionet e Shërbimit Publik të Punësimit lidhur me punësimin e të rinjve, dhe të tregohen anët e forta dhe të dobta;
- ☐ Të vlerësohet roli dhe përfshirja e partnerëve socialë në hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe programeve të punësimit të të rinjve;
- ☐ Të identifikohet se si organizatat joqeveritare, e sidomos shoqatat rinore, janë të përfshira në proces dhe nëse ekziston ndonjë institucion specifik qeveritar që mbështet punën e tyre dhe kanalizon shqetësimet e tyre në vendimet e qeverisë;
- ☐ Të formulohen përmbledhtazi problemet kryesore për punësimin e të rinjve që dalin nga analiza e kuadrit institucional dhe e mekanizmave koordinues në vendin tuaj.

- ➔ Çfarë iniciativash ka për koordinim të politikave të punësimit, e në veçanti të punësimit të të rinjve?¹⁷
- ➔ Cila është ministria dhe/ose agjencia kombëtare udhëheqëse përgjegjëse për punësimin e të rinjve? Cilat ministri dhe/ose agjenci të tjera të qeverisë qendrore merren me punësimin e të rinjve? Cili është mekanizmi koordinues i këtyre institucioneve qendrore? Vlerësoni anët e forta dhe anët e dobta.
- ➔ Si është i përfshirë Shërbimi Publik i Punësimit në punësimin e të rinjve? Çfarë shërbimesh ofron ai për të rinjtë? Vlerësoni anët e forta dhe anët e dobta.
- ➔ Cilët janë mekanizmat koordinues ndërmjet institucioneve qendrore dhe lokale që merren me punësimin e të rinjve? Si zbatohen politikat dhe programet e punësimit të të rinjve në nivel lokal? Vlerësoni anët e forta dhe anët e dobta.
- ➔ Cilët janë mekanizmat koordinues ndërmjet agjencive publike e private (përfshirë dhe agjencitë private të punësimit) që merren me punësimin e të rinjve? Vlerësoni anët e forta dhe anët e dobta.
- ➔ Ç'rol luajnë organizatat e punëdhënësve dhe punëtorëve në qeverisjen e tregut të punës së të rinjve? A kanë këto organizata iniciativa specifike për nxitjen e punësimit të të rinjve (p.sh. organizim dhe përfaqësim të sipërmarrësve të rinj dhe punëtorëve të rinj)? A trajtojnë ato çështjet e të rinjve në aktivitetet e tyre (p.sh. në dialogun social, bisedimet kolektive)? Vlerësoni anët e forta dhe anët e dobta.

¹⁷ Shih Konventën për Politikën e Punësimit (Nr. 122) dhe Rekomandimin shoqëruar (Nr. 122), 1964.

- ➔ Cili është roli i organizatave joqeveritare vendore e ndërkombëtare në iniciativat e punësimit të të rinjve?
- ➔ Në ç'mënyrë janë të përfshirë vetë të rinjtë në çështjet e punësimit të të rinjve?

1.5. Bashkëpunimi për zhvillim në punësimin e të rinjve (bashkëpunimi dy- dhe shumëpalësh, dhe IFN-ët)

Ky seksion synon të paraqesë iniciativat kryesore të punësimit të të rinjve në vend, që sponsorizohen nga donatorët dypalësh dhe/ose asistenca ndërkombëtare për zhvillim.

Udhëzime rreth bashkëpunimit për zhvillim në punësimin e të rinjve

QËLLIMI:

Të paraqiten iniciativat më kryesore dy- dhe shumëpalëshe për punësimin e të rinjve

DETYRAT:

- ☐ Të identifikohen dhe përshkruhen shkurtimisht në ç'masë kuadrot asistencës për zhvillim, përfshirë Programet Vendase për Punë të Denjë, reflektojnë punësimin për të rinjtë;
- ☐ Të identifikohen dhe përshkruhen shkurtimisht projektet dhe programet kryesore ekzistuese për punësimin e të rinjve, të financuar nga asistenca ndërkombëtare;
- ☐ Nëse është e aplikueshme, të identifikohen dhe përshkruhen edhe projektet dhe programet për të rinjtë me të cilët mund të ndërtohet sinergji gjatë zbatimit të PKA-së;
- ☐ Të përmbledhen mësimet e nxjerra nga programet e mëhershme të asistencës dy- dhe shumëpalëshe për punësimin e të rinjve;
- ☐ Të formulohen përmbledhtazi problemet kryesore të bashkëpunimit ndërkombëtar për punësimin e të rinjve në vendin tuaj.

- ➔ A është identifikuar punësimi i të rinjve si prioritet në Vlerësimin e Përbashkët të Vendit (CCA) të bërë nga Kombet e Bashkuara, dhe për rrjedhojë në Kuadrin e Asistencës për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDAF) ? Përshkruani shkurtimisht.
- ➔ A është punësimi i të rinjve prioritet në Programin Vendas për Punë të Denjë dhe në planin përkatës të punës?
- ➔ A është punësimi i të rinjve prioritet i kuadrove të tjerë të asistencës për zhvillim (p.sh. Plani i Aksionit të Programit Vendas (CPAP), Strategjia e Vlerësimit të Vendit (CAS) e Bankës Botërore)?
- ➔ Cilat janë iniciativat për punësimin e të rinjve të sponsorizuara nga asistenca ndërkombëtare, dhe cilët janë donatorët kryesorë?
- ➔ Cilat janë burimet financiare në dispozicion nga asistenca dy- dhe shumëpalëshe për zhvillim?
- ➔ Ç'mekanizma koordinues janë ngritur për të zbatuar këto iniciativa?
- ➔ A është bërë ndonjë vlerësim i këtyre iniciativave dhe, nëse po, cili ka qenë efekti i tyre në gjenerimin e punësimit të qëndrueshëm për të rinjtë? Cilat janë mësimet e nxjerra? Përshkruani shkurtimisht.

2. Përcaktimi i politikave prioritare

Bazuar në rezultatet e analizës në seksionin e mëparshëm, seksioni i dytë i PKA-së duhet të fokusohet në identifikimin e problemeve kryesore të punësimit të të rinjve dhe të politikave prioritare për të zgjidhur këto probleme në shkallë vendi, përfshirë edhe arsyetimin dhe justifikimin për prioritetet e zgjedhura.

2.1 Identifikimi dhe analiza e problemit

Udhëzime për identifikim të problemit dhe analizë

QËLLIMI:

Të identifikohen problemet që duhen trajtuar PKA-ja

DETYRAT:

- ☐ Të vendosen në një rend hierarkik problemet e identifikuara në analizën e situatës;
- ☐ Të përzgjidhen dhe përshkruhen problemet që duhen trajtuar nga PKA-ja (dhe arsyetimi për zgjedhjen e tyre);
- ☐ Të analizohet marrëdhënia shkak-pasojë e problemeve të identifikuara.

Identifikimi i problemeve kryesore të punësimit të të rinjve dhe vendosja e marrëdhënies midis shkakut dhe pasojës brenda këtyre problemeve janë thelbësore për të gjetur mënyra dhe mjete për trajtimin e tyre. Në këtë fazë të procesit të zhvillimit të PKA-së, problemet mund të identifikohen falë gjetjeve nga analiza e situatës. Kjo fazë hedh themelet për gjenerimin e opsioneve të politikave dhe renditjen e tyre sipas prioritetit për të zgjidhur problemin. Këtu jepen shkaqet dhe pasojat, si dhe marrëdhënia mes tyre, e situatës aktuale (shih figurat 2 dhe 3).

Hapat e mundshëm për identifikimin dhe përzgjedhjen e problemeve kryesore të punësimit të të rinjve që duhen trajtuar nga PKA-ja mund të jenë:

- a. *Shënohen problemet e identifikuara në secilën pjesë të analizës së situatës*
Lista duhet të plotësohet duke u kthyer prapa dhe duke shënuar “problemet” e identifikuara në fund të secilës pjesë të analizës së situatës.
- b. *Vendoset një hierarki e problemeve dhe të përzgjidhen ato që duhen trajtuar nga PKA-ja*
Hierarkia e problemeve dhe përzgjedhja e atyre që duhen trajtuar nga PKA duhet të bëhet në bazë të prioriteteve për të cilat kanë rënë dakort të gjithë aktorët e përfshirë në përgatitjen e PKA-së. Numri i problemeve që duhen trajtuar duhet të përcaktohet në mënyrë realiste, duke pasur parasysh rrethanat kombëtare, bashkë me burimet në dispozicion.

c. *Analizohen shkaqet dhe pasojat e problemeve të përzgjedhura*

Analiza duhet të zbulojë shkaqet që kanë prodhuar secilin problem të identifikuar (ky i fundit është *pasoja*) si dhe lidhjen ndërmjet vetë shkaqeve dhe pasojës së tyre përfundimtare. Ndryshe nga hapat a) dhe b), analiza e përshkruar në hapin c) duhet të reflektohet në dokumentin e PKA-së. Figurat 2 dhe 3 ilustrjnë – në mënyrë të thjeshtuar – dy shembuj të marrëdhënieve shkak-pasojë. Diagrama të ngjashme mund të përdoren edhe për analizën e problemeve kryesore dhe marrëdhënieve përkatëse shkak-pasojë, që do të trajtojë PKA-ja.

Figura 2: Marrëdhënia shkak-pasojë (pema e problemit) e numrit të madh të grave të reja në ekonominë informale





Figura 3.: Marrëdhënia shkak-pasojë (pema e problemit) e përqindjes së lartë të papunësisë së të rinjve



2.2 Gjenerimi i opsioneve të politikave

Udhëzime për gjenerim të opsioneve të politikave

QËLLIMI :

Të identifikohen opsionet e politikave që do të trajtojnë problemet e përzgjedhura të punësimit të të rinjve të ngritura në PKA

DETYRAT:

- ☐ Të identifikohen fushat kryesore të politikave për zgjidhjen e problemeve të përzgjedhura të punësimit të të rinjve;
- ☐ Të përcaktohen kriteret përmes të cilave do të vlerësohen opsionet potenciale të politikave;
- ☐ Brenda fushave të politikave, të identifikohen, renditen dhe analizohen opsionet e politikave bazuar në kriteret e përcaktuara;
- ☐ Të formulohet përmbledhtazi arsyetimi dhe justifikimi për secilin opsion të identifikuar të politikave.

Përcaktimi i politikave prioritare duhet të bazohet në identifikimin dhe vlerësimin e një numri opsionesh që iu bëjnë të mundur vendim-marrësve të zgjedhin ato politika që i konsiderojnë më efektive për trajtimin e punësimit të të rinjve. Sikurse për fusha të tjera të politikave, edhe opsionet e politikave për punësimin e të rinjve janë rezultat ndërhyrjesh përmes shumë politikash (p.sh. ato makroekonomike, sektoriale dhe sociale; politikat për arsim dhe formim; politikat për zhvillimin e ndërmarrjeve; dhe politikat e tregut të punës). Në Kutizën 3 gjendet një listë kontrolluese e fushave të politikave që duhen marrë në konsideratë gjatë zhvillimit të PKA-së.

Kutiza 3: Lista kontrolluese e fushave kryesore të politikave që kanë lidhje me punësimin e të rinjve

<i>Politikat ekonomike dhe sociale që nxisin rritje ekonomike dhe shtojnë kërkesën për punë</i>	☐ Politikat fiskale, politikat monetare dhe kursi i këmbimit ☐ Politikat tregtare ☐ Politikat financiare ☐ Politikat e investimeve dhe infrastrukturës ☐ Politikat sektoriale (p.sh. bujqësi, industri, shërbime) ☐ Politikat sociale (p.sh. shëndetësi, strehim)	EFICIENCË DHE BARAZI
<i>Arsimi dhe formimi</i>	☐ Lexim-shkrimi dhe arsimi elementar ☐ Arsimi më i lartë ☐ Arsimi dhe formimi profesional fillestar, përfshirë edhe përvojën në punë ☐ Vendi i punës dhe mësimi gjatë gjithë jetës	
<i>Zhvillimi i ndërmarrjeve</i>	☐ Krijim i mjedisit të favorshëm për biznes ☐ Zhvillimi i ndërmarrjeve shumë të vogla, të vogla dhe të mesme, përfshirë dhe kooperativat ☐ Vetëpunësimi dhe sipërmarrja e të rinjve, përfshirë mikro-kreditin	
<i>Legjislacioni i punës dhe politikat e programet e tregut të punës (PTP)</i>	☐ Legjislacioni i punës ☐ Politikat e pagave ☐ Politikat aktive të tregut të punës (p.sh. shërbimet e punësimit, informacioni i tregut të punës, punët publike, subvencionet për punësimin) ☐ Politikat pasive të tregut të punës (p.sh. përfitimet e papunësisë dhe asistencës sociale)	

Burimi: Përshtatur nga ONP-ja: Strategjia e Punësimit për Programet Vendase për Punë të Denjë: Koncepte, qasje dhe mjete për zbatimin e Axtendës për Punësim Global, GB/295/ESP/11, Organi Drejtues, Mars 2006, Gjenevë.

Çështjet e *barazisë* duhet të gjithëpërfshijë politikat e ndryshme dhe të jenë në bazë të procesit të përcaktimit të politikave prioritare me qëllim që të nxisin efikasitet dhe paanshmëri të tregut të punës së të rinjve përmes shpërndarjes së barabartë të të ardhurave dhe mundësive të barabarta për grupe të ndryshme. Në të njëjtën kohë, zgjedhja e politikave nuk mund të bëhet në dëm të atyre grupeve që janë të cënueshme në aspektin social e ekonomik. Për shembull, vendimi se si alokohen shpenzimet publike për masa specifike dhe nga cilët janë mbledhur taksat përcakton shkallën e barazisë së politikave fiskale. Në të njëjtën mënyrë, politikat prioritare për punëtorët e rinj nuk duhet të rezultojnë në zhvendosjen e punëtorëve të tjerë.

Vlerësimi i *opsioneve të politikave* të dëshirueshme mund të bëhet duke ndërtuar “*skenarë*” alternativë që vlerësojnë implikimet e mundshme të një pakete politikash karshi një pakete tjetër. Me fjalë të tjera, çdo skenar duhet të parashohë efektet e një opsioni politikash dhe t’i krahasojë ato me efektet e opsioneve të tjera të politikave. Opsionet e politikave duhet të jenë një paketë zgjedhjesh realiste. Ndaj “ushtrimi i përzgjedhjes” duhet të informohet nga një paketë kriteresh të paracaktuara. Kriteret si dëshirimi, mundësia për përballim financiarisht dhe mundësia për realizim janë kriteret që mund të përdoren për të përcaktuar suksesin ose dështimin e secilit opsion (shih kutizën 4). Ndërkohë që të tri kriteret janë njësoj të rëndësishme, vlerësimi i kostove dhe fitimeve të politikës (domethënë, përballimi financiar) është pjesa më e vështirë. Ka një sërë teknikash për të vlerësuar mundësitë për përballim financiar të opsionit të politikave siç janë modelet e llogaritjes, analiza e kostos dhe përfitimit, analiza e kostos dhe efektivitetit.

Kutiza 4: Kriteret për prioritarizimin e opsioneve të politikave

<i>Sa janë të dëshirueshme</i>	I referohet gjasave që ka një opsion politikash për të qenë “i pranueshëm” nga grupe të ndryshme të interesit. Kjo mund të vlerësohet me anë të pyetjeve si: ☐ Kush mund të ndihet i kërcënuar? ☐ Kush do të përfitojë? ☐ Çfarë do ta bënte politikën të dëshirueshme nga të gjitha grupet?
<i>Sa janë financiarisht të përballueshme</i>	Vlerësohen shpenzimi dhe fitimet e pritshme. Duke pasur parasysh shtrirjen e gjerë dhe impaktet jo të drejtpërdrejta të disa ndryshimeve të politikave apo të programeve të reja, mund të jetë e vështirë që në analizë të faktorizohen të gjithë kostot dhe përfitimet. Është me vend të identifikohen kostot dhe përfitimet më domethënëse. Kostot dhe përfitimet nuk bien tek të njëjtët. Analiza duhet të bëjë të qartë kush mbulon kostot dhe kush merr përfitimet. Burimi i fondeve është informacioni i domosdoshëm. Pyetjet që duhen ngritur janë: Koliko çë to da kosta? ☐ Sa do të kushtojë? ☐ Kush do të paguajë për të? ☐ Përfitimet a kapërcejnë kostot?
<i>Sa janë të realizueshme (fizibiliteti)</i>	I referohet burimeve të disponueshme për zbatimin e opsionit. Kjo varet nga ekzistenca e burimeve njerëzore, financiare, teknike, organizative dhe administrative. Janë me vend pyetjet e mëposhtme: ☐ A është i realizueshëm opsioni i propozuar i politikave nga këndvështrimi teknik, organizativ dhe administrativ? ☐ A ka evidenca se zgjedhja e politikës do të arrijë rezultatet e pritshme? ☐ Cili është kalendari kohor që kërkohet për të zbatuar opsionin? ☐ A është kapaciteti i personelit aktual i përshtatshëm për zbatimin e politikës? A ka nevojë personeli për trajnim dhe asistencë teknike? ☐ A do të ndikojë kosto e zhvillimit të personelit tek mundësitë për përballimin financiar të opsionit?

Burimi: Marrë nga W.D. Haddad: *Dinamika e politikëbërjes së arsimit: Studim nga rastet e Burkina Fasos, Jordanisë, Perusë dhe Tajlandës*, Banka Botërore, Uashington D.C., 1994 dhe Shkolla Kanadeze e Shërbimit Publik: *Analiza e politikave në Qeveri. Hapi 3: Identifikimi dhe Vlerësimi i Opsionit*. http://www.myschool_monocole.gc.ca/services/specialists/Analys/step3_e.html

Këto pika shqyrtimi duhet të marrin parasysh *hapsirën e politikave* në dispozicion në nivel kombëtar – domethënë, fushëveprimin për politikat e brendshme që mund të jetë në dispozicion të qeverisë në kuadër të angazhimeve dhe detyrimeve ekzistuese. Për të përzgjedhur opsione që realisht mund të zbatohen, është parësore të identifikohet kjo hapsirë që përcakton hapsirën e manovrimit të qeverisë. I mbetet politikëbërësve të identifikojnë – brenda hapsirës së dhënë – opsionin që ka gjasat më të mëdha për të sjellë mbrapsht përfitime të larta ekonomike dhe sociale. Vendimmarrësit duhet të konsiderojnë në mënyrë të njëjtë kapacitetin e Shtetit për të vepruar në përputhje me kërkesat kryesore që drejtojnë politikat publike. Këto kërkesa vihen shkurtimisht në pah në Kutizën 5.

Gjatë identifikimit të *kombinimit të politikave*, është gjithashtu e rëndësishme të shihet se disa ndërhyrje kanë gjasat të ndikojnë në punësimin e të rinjve në periudha afatshkurta deri afatmesme, ndërsa disa të tjera i shfaqin rezultatet e tyre në një periudhë më afatgjatë. Për shembull, në disa vende prioritetin më të lartë mund ta ketë reformimi i sistemit arsimor. Mirëpo, efekti i përgjithshëm i kësaj mase parandaluese për punësimin e të rinjve mund të materializohet vetëm pas një periudhe afatgjatë. Në vende të tjera, lehtësimi i kalimit të të rinjve në punë mund të identifikohet si prioritet kryesor. Politikat që stimulojnë ndërmarrjet të punësojnë të rinj mund të shfaqin rezultate në periudha afatshkurta dhe afatmesme. Në botën e vërtetë, dy llojet e masave nuk janë reciprokisht përjashtuese. Sfidat kryesore mbetet identifikimi i një kombinimi të ndërhyrjeve parandaluese dhe kurative, që mund të kenë kosto, efekt dhe kohëzgjatje të ndryshme. Po aq e rëndësishme është edhe *radhitja* e njëpasnjëshme e këtyre politikave. Kjo çon te domosdoshmëria për të identifikuar dhe radhitur politikat e ndryshme që duhen zbatuar në afate të shkurtra, të mesme e të gjata.

Si përfundim, vendimi final mbi politikat duhet të rezultojë nga vlerësimi i opsioneve të ndryshme të politikave, bazuar në gjetjet e analizës së sipërpërmendur. Në të shumtën e rasteve, politikat e duhura nuk përputhen gjithmonë me burimet në dispozicion, me kërkesat konfliktuale dhe me kuadrin ekzistues institucional. Ky i fundit është veçanërisht i rëndësishëm për t'i vënë politikat në praktikë. Ndaj, sfida kryesore është gjetja e politikave që janë teknikisht të arsyeshme dhe të mirëpërshtatura në kontekstin vendas.

Kutiza 5. Kërkesat kryesore të politikave publike

<i>Stabiliteti</i>	Aftësia për të mbajtur gjatë gjithë kohës politika përmes ndryshimeve në rritje që bazohen tek arritjet dhe konsensusi.
<i>Përshtatshmëria</i>	Masa në të cilën politikat i përshtaten kushteve ekonomike në ndryshim apo masa në të cilën ato ndryshojnë kur po dështojnë.
<i>Koherenca dhe koordinimi</i>	Shkalla e konsistencës përmes politikave që lidhen me njëra - tjetrën dhe e koordinimit midis aktorëve të përfshirë në hartimin dhe zbatimin e politikave.
<i>Cilësia e zbatimit dhe fuqizimit</i>	Masa në të cilën politikat zbatohen dhe fuqizohen efektivisht.
<i>Vëmendja ndaj publikut</i>	Masa në të cilën politikat nxisin mirëqenien e përgjithshme më tepër se interesat e individëve, grupeve apo rajoneve të veçanta gjeografike.
<i>Eficienca</i>	Aftësia e Shtetit për të alokuar burimet e pakta për politikat që sjellin mbrapsht përfitime të mëdha.

Burimi: Bazuar në Bankën Ndër-Amerikane për Zhvillim, *Politika e politikave*, Uashington DC, 2005.

3. Planifikimi

Seksioni i III-të i PKA-së duhet t'i kushtohet planifikimit të aksionit. Me saktësisht, kjo pjesë duhet të identifikojë dhe trajtojë qëllimin, objektivat e punësimit të të rinjve dhe rezultatet e pritshme të PKA-së. Kjo po ashtu duhet të tregojë edhe burimet që nevojiten dhe aranzhimet institucionale për zbatimin e saj.

3.1 Qëllimi

Udhëzime për përcaktim të qëllimit

QËLLIMI:

Të identifikohet objektivi i PKA-së dhe të ndërlidhet ky me kuadrin më të gjerë të politikave social-ekonomike

DETYRAT:

- ☐ Të formulohet qëllimi drejt të cilit synon të kontribuojë PKA-ja në kuadër të objektivave më të gjëra zhvillimore të vendit tuaj;
- ☐ Të ndërlidhet qëllimi i formuluar me kuadrin ekzistues kombëtar të zhvillimit dhe/ose politikave të punësimit.

Qëllimi duhet të tregojë objektivin e përgjithshëm për të cilin PKA-ja për punësimin e të rinjve kërkon të kontribuojë brenda qëllimeve më të gjëra zhvillimore në vend.¹⁸

Nëse vendi ka një SRV, PKA-ja mund të lidhet me të dhe të kontribuojë në arritjen e një apo më shumë objektivave të përcaktuara në të dhe, në të njëjtën kohë, të fokusohet më shumë në çështjet e punësimit të të rinjve. Kutiza 6 në vijim jep një shembull se çfarë përmban normalisht një Strategji për Reduktimin e Varfërisë.

Nëse vendi ka adoptuar një *politikë punësimi* apo një *strategji punësimi*, qëllimi i PKA-së duhet të përkojë me qëllimin e kësaj politike. Një shembull i një qëllimi politike punësimi jepet në Konventën për Politikën e Punësimit (Nr.122), të vitit 1964, që parashikon si qëllim madhor “nxitjen e punësimit të plotë, produktiv dhe të zgjedhur lirisht”. Ky qëllim reflektohet në politikën dhe strategjitë e punësimit të shumë vendeve që kanë ratifikuar këtë Konventë.

¹⁸ Në shumicën e shteteve Kuadri për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara duhet të përdoret si pikë referimi.

Kutiza 6: Përmbajtja e dokumentit të SRV

Çështjet makroekonomike dhe strukturore

- ☐ Rritja dhe punësimi
- ☐ Kuadri ekonomik
- ☐ Politikat fiskale dhe monetare
- ☐ Politikat tregtare dhe tregjet
- ☐ Privatizimi

Statusi i varfërisë

- ☐ Diagnoza e varfërisë urbane e rurale
- ☐ Pabarazia, përkrahja sociale, etniciteti, të rinjtë, gjinia
- ☐ Bujqësia dhe reforma e tokave

Procesi konsultativ

- ☐ (*Kush, ku, si, dhe kur të bëhet dialogu social*)
- ☐ Procesi i deritanishëm
- ☐ Angazhimet e ardhshme

Mirëqeverisja

- ☐ (ndonjëherë e trajtuar si çështje gjithëpërfshkuese)
- ☐ Reforma ligjore/nënligjore/e drejtësisë
- ☐ Reforma e shërbimit civil
- ☐ Reforma e qeverisjes vendore/decentralizimi
- ☐ Menaxhimi financiar publik
- ☐ Korrupsioni

Zhvillimi/aftësimi njerëzor

- ☐ Shëndetësia/ushqimi
- ☐ Arsimi
- ☐ Të drejtat e njeriut
- ☐ Mbrojtja sociale/ përfshirja sociale/ cënueshmëria/rrjetet e sigurisë
- ☐ Tregu i punës

Sektori privat

- ☐ Mjedisi i favorshëm për biznes
- ☐ Ekonomia informale
- ☐ Kooperativat
- ☐ Kreditë/bankat
- ☐ Teknologjia informative dhe e komunikimit
- ☐ Burimet natyrore për prodhim

Infrastruktura

- ☐ Energjitika
- ☐ Transporti
- ☐ Uji dhe higjiena
- ☐ Shërbimet komunale

Monitorimi dhe analiza e varfërisë

- ☐ Rregullimet institucionale për monitorimin e varfërisë
- ☐ Treguesit, synimet dhe OZHM-ët (MDGs) e SRV-ës
- ☐ Forcimi i sistemit statistikor

Çështjet gjithëpërfshkuese

- ☐ Gjinia
- ☐ HIV/AIDS (SIDA)
- ☐ Mjedisi
- ☐ Komunikimi strategjik në dokumentin e SRV-ës
- ☐ Zhvillimi i orientuar në komunitet

Matrica e politikave

- ☐ Objektivat, ecuria e deritanishme, veprimet e planifikuara
- ☐ Kosto, financimi, buxheti dhe kuadri i shpenzimeve afatmesme

Çështjet specifike të vendit

- ☐ Puna e fëmijëve
- ☐ Migracioni
- ☐ Konfliktet/siguria/ gatishmëria ndaj katastrofave
- ☐ Trafikimi i qenieve njerëzore
- ☐ Siguria e artikujve ushqimorë

Burimi: Përshtatur nga ONP-ja, Strategjia për Punë të Denjë dhe Reduktim të Varfërisë (SRV) – Doracak reference për anëtarët dhe personelin e ONP-ës, Gjenevë, 2005

3.2 Objektivat dhe synimet e punësimit të të rinjve

Udhëzime për objektivat dhe synimet e punësimit të të rinjve

QËLLIMI:

Të përcaktohen objektivat që duhen arritur nga PKA-ja dhe synimet shoqëruese

ZADACI:

- ☐ Të identifikohen dhe përcaktohen objektivat që mund të arrihen realisht brenda kuadrit kohor të PKA-së;
- ☐ Nëse ekziston një politikë apo strategji punësimi:
 - të përkohet objektivat specifike të PKA-së me ato përkatëse të politikës/strategjisë së punësimit; ose
 - të identifikohen synimet specifike për të rinjtë që mund të ndërlidhen me objektivat e strategjisë së punësimit;
- ☐ Të identifikohen dhe përcaktohen një apo më shumë synime të matshme për secilin objektiv;
- ☐ Kur vendosen objektivat dhe veçanërisht synimet, të merren në konsideratë çështjet gjinore.

Objektivat duhet të tregojnë se çfarë synon të arrijë PKA-ja në fund të zbatimit të saj (impakti afatgjatë). Në shumicën e rasteve, një objektivi i punësimit të të rinjve mund të arrihet përmes kombinimit të politikave të ndryshme. Për këtë arsye, numri i objektivave duhet të jetë i kufizuar dhe formulimet e objektivave duhet të mbahen sa më të qarta dhe koncize që është e mundur.

Secili objektivi duhet të shoqërohet me një apo më shumë synime të matshme apo të verifikueshme që duhen arritur. Synimet shërbejnë si pika referimi për monitorimin e përparimit të bërë drejt arritjes së objektivave dhe për vlerësimin e impaktit të PKA-së. Ato ndihmojnë të identifikohen nevojat që duhen përmbushur dhe kur. Ato përfaqësojnë një angazhim që duhet të përmbushë vendi. Çështjet e barazisë në përgjithësi dhe të barazisë gjinore në veçanti duhet të merren parasysh gjatë përcaktimit të synimeve. Kjo mund të kërkojë ndarjen e synimeve sipas gjinisë kur është e mundur dhe vendosjen e synimeve specifike si për të rinjtë dhe për të rejtat.

Kutiza 7 paraqet një shembull të një objektivi punësimi për të rinjtë dhe dy synime që lidhen me të.

Kutiza 7. Objektivat dhe synimet e punësimit të të rinjve

Një problem i dukshëm që del nga analiza e situatës në vendin Sunshine është se sistemi i AFP-ës nuk i përgjigjet kërkesave të tregut të punës. Si pasojë, të rinjtë e trajnuar, veçanërisht të rejtat, kanë një përqindje të ulët punësimi. Më tej, të rinjtë e veçanërisht të rejtat që i përkasin minoriteteve etnike hasin vështirësi shtesë. Ata kanë një përqindje më të lartë braktisjeje dhe një përqindje më të ulët punësimit krahasuar me të rinjtë e tjerë. Analiza e politikave identifikoi, kështu, si probleme parësore lidhur me punësimin e të rinjve relevancën e ulët në përgjithësi të sistemit të AFP-ës dhe nivelin e lartë të papunësisë dhe dekurajimit në mesin e të rinjve nga pakicat etnike. Ekipi Teknik Kombëtar pranoi se "përmirësimi i qasjes dhe relevanca e sistemit të AFP-ës" duhej të ishin prioriteti i politikave të PKA-së në Sunshine. Ndaj, u vendosën objektivat dhe synimet e mëposhtme:

- ☐ **Objektivi 1.** Të përmirësohet qasja në sistemin e AFP-ës dhe të rritet relevanca e tij.
Synimi: Përqindja e të rinjve të trajnuar të vendosur në punë të përhershme të rritet me 40% dhe e femrave të reja me 55% në pesë vitet e ardhshme.
- ☐ **Objektivi 2.** Të parandalohet përjashtimi social i të rejave dhe të rinjve që i përkasin minoriteteve etnike duke përmirësuar perspektivat e tyre për punësim.
Synimi: Në vitin X, përqindja e punësimit të të rinjve nga minoritetet etnike rritet me 10%.

Nëse vendi ka miratuar një *politikë punësimi*, objektivat e PKA-së duhet të përkohet me ato të politikës së punësimit. Kjo qasje do të mundësojë

vendosjen e punësimit të të rinjve (si qëllim horizontal) në komponentët e ndryshëm të politikës së punësimit. Kur kemi politika dhe strategji punësimi të mirëartikuluara, PKA-ja mund të kontribuojë ta bëjë punësimin e të rinjve një prioritet horizontal duke vendosur synime specifike për të rinjtë (Shih Kutizën 8).

Kutiza 8: Punësimi i të rinjve në Strategjinë Evropiane të Punësimit

Strategjia Evropiane e Punësimit e miratuar nga Bashkimi Evropian është qasje e integruar e politikave të punësimit e qendëruar në objektivat e gjera të zbatimit "të politikave të punësimit që synojnë arritjen e punësimit të plotë, përmirësimin e cilësisë dhe produktivitetit në punë, dhe forcimin e kohezionit social e territorial". Vendet udhëzohen që të përcaktojnë objektiva të përbashkëta të artikuluara rreth tri sferave (të tërhiqen dhe mbahen më shumë njerëz në punësim, të rritet oferta e fuqisë punëtore dhe të modernizohen sistemet e mbrojtjes sociale; të përmirësohet përshtatshmëria e punëtorëve dhe ndërmarrjeve; dhe të shtohen investimet në kapitalin njerëzor përmes arsimit dhe aftësisë më të mire)*.

Për t'i ndihmuar vendet në monitorimin e ecurisë është dhënë një paketë synimesh. Katër prej tyre janë veçanërisht të lidhura me të rinjtë. Ato janë: (i) deri në vitin 2010 të rritet në 70 përqind punësimi i përgjithshëm dhe nga kjo 60 përqind punësimi i grave; (ii) secilit person të ri të papunë duhet t'i ofrohet një fillim i ri në formë trajnimi, ritrajnimi, praktike në punë, një punë apo masë tjetër punësimi përpara se të arrijë gjashtë muaj në papunësi; (iii) deri më 2010, 85 përqind e 22 vjeçarëve duhet të kenë përfunduar shkollimin e mesëm të sipërm; dhe (iv) deri më 2010, numri i atyre që lënë shkollën para kohe të mos jetë më i madh se 10%.

* Strategjia e parë Evropiane e Punësimit u ndërtua rreth katër shtyllave (që janë: punësueshmëria, përshtatshmëria, sipërmarrja dhe mundësitë e barabarta). Tani ajo ka evoluar në prioritetet kyçe të sipërpërmendura për të adoptuar një qasje të integruar të politikave të punësimit. Të dy qasjet, si ajo e "shtyllave" dhe ajo e "prioriteteve kyçe të politikave" përdoren për hartimin dhe zhvillimin e strategjive të punësimit.

Burimi: Komisioni Evropian: *Udhëzime të integruara për rritje dhe vende pune (2005-08)*, Luxembourg, 2005.

3.3 Rezultatet dhe treguesit kryesorë operacionalë

Udhëzime për rezultatet dhe treguesit operacionalë

QËLLIMI:

Të identifikohen rezultatet që do të prodhohen në fund të PKA-së dhe të përcaktohen treguesit e performancës për matjen e tyre.

DETYRAT:

- ☐ Të identifikohen dhe përcaktohen rezultatet që çojnë në ndryshime të prekshme të politikave dhe/ose institucioneve brenda kuadrit kohor të PKA-së;
- ☐ Gjatë përcaktimit të rezultateve, të përshkruhen ato si përfundime realisht të arritshme, e jo si veprime apo mjete dhe gjithnjë të lidhet secili prej tyre me një objektiv të punësimit të të rinjve;
- ☐ Për secilin rezultat, caktoni një apo më shumë tregues SMART të performancës ku së paku një të jetë sasior;
- ☐ Kur përcaktohen rezultatet dhe treguesit, të merren në konsideratë çështjet gjinore.

Rezultatet operacionale duhet të tregojnë një ndryshim të prekshëm në politika dhe/ose institucione që pritet të ndodhë brenda kuadrit kohor të dhënë në PKA (impakti afatmesëm). Prandaj, rezultatet duhet të shprehen në formë përfundimesh realisht të arritshme, e jo si veprime që duhen ndërmarrë apo si mjete që duhen përdorur. Kur përcaktohet formulimi i një rezultati, duhet mbajtur në mendje fushëveprimi i PKA-së, si dhe burimet që mund të jenë në dispozicion. Me fjalë të tjera, ndryshimi i pritshëm duhet të barazpeshohet me burimet që mund të jenë në dispozicion dhe me fushëveprimin e PKA-së.

Rezultatet janë esenciale për arritjen e objektivave, dhe si të tilla gjithmonë duhen lidhur me njërin prej tyre. Grupi i rezultateve që i bashkëngjiten një

objektivi specifik mund të sjellë ndryshim përgjatë politikave dhe/ose institucioneve të ndryshme. Për shembull, një objektivi që synon të përmirësojë kushtet e punës të të rinjve të moshës 15-17 vjeç që punojnë në punë të rrezikshme mund të arrihet përmes kombinimit të rezultateve që ndikojnë në legjislacionin e punës, në administratën e punës dhe në mjedisin e biznesit. Këto rezultate mund të përfshijnë: rishikim të politikave që lidhen me llojet e punëve të rrezikshme që mund të dëmtojnë shëndetin ose zhvillimin e punëtorëve të rinj nën moshën 18 vjeçare; rritjen e kapaciteteve të inspektoratit të punës për zbatim të legjislacionit të punës për eliminimin e punës së fëmijëve dhe mbrojtjen e punëtorëve të rinj; thjeshtësimin e procedurave për ndërmarrjet në sektorët me rrezikshmëri të lartë për t'u regjistruar si subjekte të ligjshme.

Identifikimi i rezultateve është kusht i domosdoshëm por jo i mjaftueshëm. Për secilin rezultat të identifikuar duhen përcaktuar tregues konkretë dhe me ndjeshmëri gjinore. Këta tregues janë të rëndësishëm për të matur performancën dhe për të monitoruar ecurinë në afate kohore. Ata duhet të jenë *specifikë, të matshëm, të arritshëm, relevantë dhe të lidhur me afate* (SMART).

Informacioni i mbledhur mbi këta tregues shërben për menaxhimin e vendim-marrjes që e mban PKA-në në rrugën e duhur drejt arritjes së objektivave të saj. Si rregull, secili rezultat duhet të ketë së paku një tregues sasior. Treguesit sasiorë duhet të bazohen për krahasim në një njësi analize apo llogaritjeje, në të dhëna bazë apo pika referimi ekzistuese (p.sh. shifra, përqindje, raporte).

Bazuar në shembullin e përmendur më sipër, treguesit e performancës mund të përfshijnë: numrin e saktë të ligjeve që duhen ndryshuar me qëllim të rishikimit të politikave që lidhen me punët e rrezikshme sipas faktorit të saktë kohor (kjo do të thotë që ligjet identifikohen përpara se të përcaktohet treguesi); përqindjen e rritjes në përputhje me legjislacionin e punës të vizitave inspektuese sipas faktorit të saktë kohor; një reduktim në përqindje të saktë të numrit të dokumentave administrativë të domosdoshëm për të regjistruar një ndërmarrje të sektorit të rrezikshmërisë së lartë sipas faktorit të saktë kohor.

Kutiza 9 jep një shembull të rezultateve në punësimin e të rinjve si dhe treguesit përkatës, të lidhura këto me shembujt e objektivave dhe synimeve të ilustruara në Kutizën 7.

3.4 Burimet

Udhëzime për burimet

QËLLIMI:

Të planifikohen burimet që do të kërkohen për zbatimin e PKA-së..

DETYRAT:

- ☐ Të vlerësohen burimet (njerëzore, materiale dhe financiare) që do të kërkohen për zbatimin e PKA-së dhe të tregohen institucionet përkatëse kombëtare që do t'i sigurojnë këto inpute;
- ☐ Të ndahen burimet sipas rezultatit;
- ☐ Të identifikohen mungesat financiare dhe burimet e mundshme të financimit nga jashtë;
- ☐ Të përfshihet ndarja e inputeve në PKA.

Sikurse është përmendur më parë në këtë Udhëzues (shih Pjesën II, Seksionin 2) një veçori kryesore e politikave publike është mundësia e Shtetit për të alokuar burimet e pakta në ato iniciativa që sjellin mbrapsht fitime të mëdha. Për këtë arsye PKA-ja duhet të identifikojë burimet njerëzore, materiale dhe financiare që do të kërkojnë për zbatimin e saj. Këto burime duhet të jenë në një linjë me shtrirjen e PKA-së. Më saktësisht, për secilin rezultat mund të bëhet një vlerësim i shëndoshë i burimeve të domosdoshme. Ky ushtrim është thelbësor për suksesin përfundimtar të PKA-së. Nënvlërsimet mund të pengojnë zbatimin e PKA-së. Mbiavlërsimet mund të mos kalojnë testin e efikasitetit.

Përsa i përket inputeve financiare, pasi të jetë përcaktuar shuma e përgjithshme e burimeve të nevojshme, do të jetë e mundur të identifikohet deri në ç'masë financimi mund të mbulojë nga buxheti kombëtar. Në rast mungesash financiare, autoritetet vendase mund ose t'i trajtojnë gradualisht prioritetet e PKA-së ose të shohin mundësitë për financim përmes bashkëpunimit dy- dhe shumëpalësh. PKA-ja duhet të përmbajë ndarjen e këtyre inputeve si dhe të tregojë burimet e financimit.

Kutiza 9. Rezultatet dhe treguesit e punësimit të të rinjve

Për të arritur objektivat dhe synimet e përcaktuara në PKA-në e Sunshine, Ekipi Teknik Kombëtar ka formuluar këto rezultate dhe tregues performance:

Rezultatet dhe treguesit e lidhur me Objektivin 1 :

- **REZULTATI 1.1.:** Sistemi i AFP-ës i reformuar për të ofruar qasje të barabartë për të rinjtë dhe të reja në formimin profesional.

Treguesit:

- Përqindja e regjistrimit të të reja në sistemin e AFP-ës është e barabartë me atë të të rinjve në vitin X.
- Numri i të reja që kanë përfunduar trajnimet në sistemin e AFP-ës rritet me 25% në vitin Y.
- Pjesëmarrja e të reja në trajnime për profesione jo-tradicionale është 35% në vitin Z.

- **REZULTATI 1.2.:** Politika e AFP-ës e rishikuar për t'iu përgjigjur nevojave të tregut të punës, duke përfshirë këtu edhe dhënien e përvijës së punës.

Treguesit:

Në vitin Z:

- 70% e programeve të AFP-ës janë të hartuara në bazë të parashikimeve të tregut të punës dhe nevojave të identifikuar nga ndërmarrjet
- 85% e programeve të AFP-ës është e orientuar tek kompetencat
- 60% e programeve të AFP-ës përmbajnë komponentin e përvijës në punë, përfshirë partneritetin publik-privat.

Rezultatet dhe treguesit lidhur me Objektivin 2

Objektivi 2: Të parandalohet përjashtimi social i të reja dhe të rinjve që i përkasin minoriteteve etnike duke përmirësuar perspektivat e tyre për punësim

- **REZULTATI 2.1.:** Numri i të rinjve nga minoritetet etnike që kanë gjetur punë përmes programeve të aktivizimit është rritur.

Treguesit:

Në vitin Z:

- Numri i të rinjve nga minoritetet etnike që kanë përfituar nga PATP-ët është rritur me 40%.
- Numri i të rinjve nga minoritetet etnike të përfshirë në masat e përkrahjes sociale është zvogëluar me 25%.

- **REZULTATI 2.2.:** Numri i punëtorëve të rinj nga minoritetet etnike që kaluan nëpër vende pune në sektorin formal është rritur

Treguesit

Në vitin Z:

- Masat e reja nxitëse rezultuan në formalizmin e kontratave të punës për 25.000 të rinj nga minoritetet etnike
- 40.000 punëtorë të rinj kanë rregulluar statusin e tyre të punësimit si rezultat i masave të inspektimit të punës.
- 20.000 punëtorë të rinj nga minoritetet etnike fituan punësim të denjë pas zbatimit të politikave anti-diskriminuese.

3.5 Zbatimi dhe mekanizmat koordinues

Udhëzime për mekanizmin kombëtar të koordinimit

QËLLIMI:

Të identifikohet dhe përshkruhet mekanizmi që do të koordinojë zbatimin e PKA-së

DETYRAT

- ☐ Të identifikohet dhe përshkruhet mekanizmi institucional që do të ngrihet dhe/ose ngarkohet të koordinojë efektivisht zbatimin e PKA-së në nivel kombëtar dhe lokal;
- ☐ Të përshkruhen rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve udhëheqëse qeveritare;
- ☐ Të tregohen përbërja, rolet dhe përgjegjësitë e organit koordinues dhe, nëse është e mundur, të grupeve teknike të punës që parashikohen.

Siç u pa në Kutizën 3, numri i politikave që ndikojnë në punësimin e të rinjve prek ministri të ndryshme të qeverisë (p.sh. tregtinë, industrinë, financat, arsimin dhe formimin, punësimin, çështjet e rinisë, etj.). Këtu përfshihen si institucionet qendrore ashtu dhe ato lokale, bashkë me organizatat e punëdhënësve dhe punëtorëve dhe agjenci të tjera (Shërbimet Publike të Punësimit, agjencitë private të punësimit, ofruesit e arsimit dhe formimit).

Për të siguruar koherencë gjatë zbatimit të PKA-së, është e rëndësishme të ngrihet një mekanizëm koordinues që identifikon qartë rolet dhe përgjegjësitë e palëve të ndryshme. Ky mekanizëm mund të përfshijë:

- A. Institucionin udhëheqës qeveritar që është i ngarkuar të koordinojë zbatimin e PKA-së. Ky institucion do të vepronte si sekretariat i përhershëm i organit koordinues.
- B. Një organ koordinues (p.sh. komitet drejtues, bord këshillues) ku bëjnë pjesë të gjitha ministratë e linjave të përfshira në zbatimin e PKA-së, bashkë me organizatat e punëdhënësve dhe punëtorëve. Ministratë duhet të identifikohen në bazë të politikave prioritare dhe rezultateve për të cilat do të marrin përgjegjësitë përkatëse. Përfaqësuesit e shoqërisë civile, sidomos grupet rinore, duhet të jenë gjithashtu pjesë e këtij organi koordinues. Ky i fundit duhet të ketë detyra specifike pune dhe të mbledhet rregullisht ose sipas kërkesës. Organi koordinues mund të ngrejë grupe teknike pune të posaçme (ad-hoc) për detyra specifike (p.sh. draftimi i projekt-ligjeve, zhvillimi i strategjive). Përbërja e këtyre grupeve të punës varet nga detyrat dhe ekspertiza e kërkuar.

Kutiza 10 paraqet shembullin e një mekanizmi koordinues të ngritur përmes ndihmës teknike të ONP-ës.

Zbatimi i PKA-së duhet të përfshijë edhe koordinimin ndërmjet institucioneve dhe aktorëve lokalë. Përvojat nga shumë iniciativa të punësimit të të rinjve tregojnë se ndarja e detyrave tek autoritetet rajonale dhe lokale lehtëson përmbushjen e kërkesave lokale dhe marrjen e vendimeve që janë më afër nevojave të përfituesve të fundmë. Në këtë kontekst, mund të parashihet një aranzhim koordinimi në nivel të decentralizuar. Ka shumë gjasa që një aranzhim i tillë t'i ngjajë atij të nivelit qendror.

Kutiza 10. Shembulli i mekanizmit koordinues për zbatimin e Planit të Aksionit për Punësimin e të Rinjve të Kosovës.

Zyra e Kryeministrit (ZKM)	Zyra e Kryeministrit do të kryejë koordinimin e përgjithshëm lidhur me zbatimin e Planit të Aksionit për Punësimin e të Rinjve. ZKM-ja në mënyrë më specifike do të: ☐ Organizojë ngritjen e një Komiteti Ndërmintor për Punësimin e të Rinjve që do të përbëhet kryesisht nga ata zyrtarë publikë që hartuan Planin e Aksionit. Këta zyrtarë do t'i japin Ministrive të tyre përkatëse si dhe ZKM-ës mbështetje, këshilla dhe orientim teknik për të gjitha aspektet lidhur me zbatimin e Planit të Aksionit. Komiteti Ndërmintor do të përgatisë raporte periodike ecurie dhe monitorimi dhe do të ndihmojë në përgatitjen e raporteve të vlerësimit të Planit të Aksionit. ☐ Lehtësojë shkëmbimin e informacionit dhe praktikave më të mira ndërmjet agjencive qeveritare qendrore dhe lokale si dhe midis Qeverisë dhe shoqërisë civile.
Komiteti Ndërmintor për Punësimin e të Rinjve (KNPR)	Pas miratimit të Planit të Aksionit për Punësimin e të Rinjve, KNPR-ja do të: ☐ Ofrojë konsulencë ekspertësh dhe do të ndihmojë ministrinë kryesore si dhe ZKM-ën të përcaktojnë programet dhe detyrat e duhura si dhe ngarkesën e punës ndërmjet ministrive, institucioneve, agjencive lokale qeveritare, organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të tjera të përfshira në zbatimin e Planit të Aksionit. ☐ Hartojë dhe rishikojë udhëzimet e duhura që mund të ndihmojnë ministrinë kryesore dhe qeverinë lokale të kryejnë në mënyrë eficiente punën e tyre në fushën e punësimit të të rinjve; ☐ Këshillojë ministrinë kyçe dhe institucionet e qeverisjes lokale për çështje teknike lidhur me zbatimin e programeve për punësimin e të rinjve; ☐ Ofrojë ndihmë për donatorët dhe njësitë koordinuese të asistencës teknike në lidhje me programet dhe projektet për punësimin e të rinjve; ☐ Monitorojë arritjen e objektivave si dhe do t'i japë komente ministrive kyçe, autoriteteve lokale dhe ZKM-ës për veprimet korrigjuese që duhen ndërmarrë; ☐ Ofrojë asistencë teknike për ndjekjen në vazhdimësi të rekomandimeve të Kombeve të Bashkuara dhe rekomandimeve të tjera globale dhe rajonale mbi të rinjtë; Ndihmojë në identifikimin e studimeve që janë të nevojshme në fushën e zhvillimit të të rinjve si dhe do të kontribuojë në ndërmarrjen e këtyre studimeve.

PLANI AKCIONAL I PUNËSIMIT TË TË RINJVE NË KOSOVË Kornizë e politikave afatmesme 2007-2010, Tetor, 2006

Kutiza 11. Kriteret primare vlerësuese

Kriteret për vlerësim	Përkufizimi
<i>Relevanca</i>	masa në të cilën objektivat e Planit të Aksionit justifikohen me nevojat, nëse ato ishin/janë relevante dhe i korrespondojnë prioritetëve lokale dhe kombëtare;
<i>Efektiviteti</i>	masa në të cilën objektivat janë arritur; nëse ndërhyrjet dhe mjetet e përdorura kanë pasur impaktin e pritur; nëse mund të përftohej më shumë duke përdorur mjete të tjera;
<i>Eficienca</i>	nëse objektivat janë arritur me koston më të ulët të mundshme dhe nëse mund të përftoheshin rezultate më të mira me të njëjtën kosto;
<i>Dobia</i>	nëse rezultatet e pritura dhe jo-të pritura janë të kënaqshme nga këndvështrimi i përfituesve të drejtpërdrejtë dhe jo- të drejtpërdrejtë;
<i>Qëndrueshmëria</i>	masa në të cilën rezultatet dhe impakti, përfshirë këtu edhe ndryshimet institucionale, janë jetëgjatë dhe nëse ato do të vazhdojnë edhe në mungesë të financimit të mëtejshëm.

3.6. Monitorimi dhe vlerësimi

Udhëzime për monitorim dhe vlerësim

QËLLIMI:

Të identifikohet dhe përshkruhet sistemi që do të ngrihet për të monitoruar dhe vlerësuar PKA-në.

DETYRAT:

- ☐ Të përshkruhet sistemi dhe mjetet që do të përdoren për monitorim të PKA-së;
- ☐ Të tregohen aktivitetet e monitorimit që do të ndërmerren për të matur ecurinë dhe performancën e rezultateve karshi treguesve të përcaktuar;
- ☐ Të përshkruhet mekanizmi që do të aplikohet për vlerësim të PKA-së;
- ☐ Të identifikohen aktorët që do të marrin pjesë në monitorim dhe vlerësim;
- Të sigurohemi që monitorimi dhe vlerësimi të kenë ndjeshmëri gjnore.

Sistemet e monitorimit dhe vlerësimit janë mjete menaxhimi që mund të përdoren nga agjencitë qeveritare për qëllime të llogaridhënies dhe transparencës, si dhe për të treguar rezultatet. Ato, po ashtu, ndihmojnë në rritjen e koherencës ndërmjet politikave, planeve dhe projekteve.

Monitorimi përmirëson menaxhimin e PKA-së në përgjithësi duke siguruar informacion dhe komente nga të gjitha palët e përfshira. Ky shërben kryesisht për të vlerësuar ecurinë e punës në vazhdim dhe përdorimin e burimeve të alokuara. Ky informacion mundëson marrjen e masave korrektuese në kohë në mënyrë që të sigurohet konsistencë ndërmjet planifikimit dhe zbatimit. Nën këtë këndvështrim, sugjerohet që planet e aksionit të rishikohen të paktën një herë në vit dhe, nëse është e nevojshme, të rishikohen sipas nevojave që ndryshojnë. Sikurse u përmend më lartë, treguesit e performancës janë shumë të rëndësishëm për monitorim siç duhet.

Vlerësimi mundëson verifikimin e suksesit apo dështimit të përgjithshëm të PKA-së. Vlerësimi synon matjen e performancës së objektivave të punësimit të të rinjve në aspektin e relevancës, eficiencës, efektivitetit, dobisë dhe qëndrueshmërisë (dmth. impaktin afatgjatë). Kutiza 11 ilustron përkufizimin e këtyre kriterëve primare vlerësuese, ndërsa Mjeti 7 jep një shembull të çështjeve dhe pyetjeve të vlerësimit të PKA-së. Po ashtu, vlerësimet janë të dobishme për të nxjerrë mësimë që dalin nga zbatimi dhe që mund të përdoren në ndërhyrje të ardhshme.

Ky seksion i PKA-së duhet të përmbajë dispozita lidhur me mënyrat e monitorimit dhe vlerësimit. Kështu, ai duhet të japë qartë rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve të përfshirë në procesin e monitorimit dhe vlerësimit. Për shembull, nëse ngrihet një mekanizëm ndër-institucional për këtë qëllim, duhen përgatitur raporte periodike për të kontrolluar nëse zbatimi i PKA-së po kryhet sipas programit dhe nëse masat po arrijnë rezultatet e planifikuara. Këto raporte duhet të identifikojnë gjithashtu institucionet dhe stafin përgjegjës për livrimin e PKA-së.

4. Identifikimi i dokumenteve që i duhen bashkëngjitur PKA-së

4.1 Matrica e PKA-së

Matrica është mjet i dobishëm për të vizualizuar marrëdhëniet funksionale ndërmjet elementëve të ndryshëm të Planit Kombëtar të Aksionit për Punësimin e të Rinjve (objektivave, synimeve, rezultateve, treguesve, përgjegjësi dhe inputeve). Po ashtu, ajo siguron një fotografi të çastit të informacionit kryesor në formë table. Një shembull jepet në Mjetin 7 në Pjesën e III-të të këtij Udhëzuesi.

4.2 Plani i punës së PKA-së

PKA-ja duhet të përmbajë në një aneks të veçantë projekt-planin e punës që do të drejtojë zbatimin e saj. Ky plan pune duhet të japë informacion mbi rezultatet (outputet) që duhen prodhuar dhe mbi aktivitetet që duhen ndërmarrë për të livruar rezultatet përfundimtare (outcome).¹⁹ Ai duhet të tregojë edhe kalendarin e zbatimit të aktiviteteve dhe njësinë përgjegjëse për livrim.

Është me rëndësi të mbahet në mendje dallimi ndërmjet planifikimit dhe zbatimit. Përderisa PKA-ja, sikurse konceptohet në këtë Udhëzues, është mjet planifikimi, plani i punës shërben për të lehtësuar zbatimin e Planit. Ndaj, që të dy janë mjete të rëndësishme dhe komplementare për të mbështetur vendet në nxitjen dhe zbatimin e strategjive për punë të denjë dhe produktive për të rinjtë. Një model plani pune propozohet në Mjetin 8.

4.3 Portofoli i projekteve të PKA-së

Nisur nga spektri i iniciativave që mund të dalin nga aktorë të ndryshëm që mund të jenë të përfshirë në PKA, mund të mendohet që edhe zbatimi të kryhet përmes projekteve të dedikuara. Këto projekte, mbështetur edhe në asistencën ndërkombëtare për zhvillim, do të shërbenin për të livruar një apo më shumë rezultate. Për këtë arsye, PKA-ja duhet të përfshijë në një aneks një portofol të skicë-projekteve. Secila skicë duhet të tregojë lidhjet e projektit me PKA-në, si dhe outputet dhe kërkesat buxhetore. Ajo nuk duhet të jetë më e gjatë se dy faqe pasi zhvillimi i propozim-projektit të plotë normalisht bëhet në një fazë të mëvonshme. Mjeti 9 propozon një model skicë-projekti.

¹⁹ *Rezultatet (outputet)* janë produktet që rezultojnë nga aktivitetet e një ndërhyrjeje për zhvillim (p.sh. inspektorët e punës të trajnuar, procedura të reja inspektimi të punës të futura dhe të përdorura). Ato përfaqësojnë rezultatet që kontribuojnë në arritjen e rezultatit përfundimtar (outcome). Aktivitetet janë veprime që ndërmerren për të prodhuar outputin e planifikuar (p.sh. kryerja e seminareve për ngritje të kapaciteteve të inspektorëve të punës, zhvillimi i materialeve trajnuese, rishikimi i procedurave ekzistuese të inspektimit, vlerësimi i relevancës së tyre, draftimi i procedurave të reja).

4.4 Normat Ndërkombëtare të Punës dhe legjislacioni vendas për punën dhe të rinjtë

Normat ndërkombëtare të punës ofrojnë një pikë referimi drejtësie për qeverisjen e tregut të punës së të rinjve. Ato udhëzojnë vendet mbi një sërë politikash dhe masash që kanë të bëjnë me të drejtat në punë, punësimin, mbrojtjen sociale dhe dialogun social. Për këtë qëllim, normat ndërkombëtare të punës që janë relevante për punësimin e të rinjve janë dhënë në Mjetin 10. Lista e Konventave të ratifikuara nga vendi, si dhe legjislacioni përkatës vendas që aplikon dispozitat e këtyre Konventave duhet t'i bashkëngjiten PKA-së.

PJESA III.

Paketa e modeleve dhe matricave për Planin Kombëtar të Aksionit për Punësimin e të Rinjve



Mjeti 1

Skica dhe përmbajtja e propozuar e dokumentit të PKA-së

Dokumenti i PKA-së më tepër se një dokument analitik duhet të jetë një dokument operacional që të përcaktojë drejtimet dhe të udhëzojë veprimet e ardhshme në punësimin e të rinjve në vend. Struktura e propozuar e PKA-së duhet të përdoret si një kuadër i përbashkët. Fleksibiliteti mund të aplikohet varësisht nga specifikat e vendit dhe, në veçanti, nëse ka mungesë informacioni në vend.

Seksionet kryesore		Nën-seksionet
I.	Analiza e situatës	Vështrim mbi kontekstin makroekonomik dhe social
		Analiza e tregut të punës së të rinjve
		Rishikim i politikave dhe programeve ekzistuese që ndikojnë në punësimin e të rinjve
		Kuadri dhe koordinimi institucional rreth punësimit të të rinjve
		Bashkëpunimi zhvillimor rreth punësimit të të rinjve (dy- dhe shumëpalësh, dhe IFN-ët)
II.	Prioritetet kryesore të politikave	Identifikimi dhe analiza e problemit
		Politikat prioritare
III.	Planifikimi i aksionit	Qëllimi
		Objektivat dhe synimet e punësimit të të rinjve
		Rezultatet dhe treguesit kryesorë operacionalë
		Burimet
		Zbatimi dhe mekanizmi koordinues
		Monitorimi dhe vlerësimi
Aneke		
I	Matrica e PKA-së	
II	Plani i punës së PKA-së	
III	Skicë-projekti i PKA-së	
IV	Lista e Normave Ndërkombëtare të Punës dhe legjislacioni vendas për punën dhe të rinjtë	

Mjeti 2

Treguesit për paraqitjen e gjendjes së përgjithshme të tregut të punës

Ky mjet jep një listë të treguesve kryesorë të tregut të punës. Ai përbëhet nga një listë gjithëpërfshirëse e treguesve të dëshirueshëm që do të siguronin një pasqyrë të plotë të gjendjes së tregut të punës në vend. Lista duhet të shërbejë si instrument që udhëzon vendet në identifikimin e informacionit të disponueshëm.²⁰ Ky informacion zakonisht ofrohet nga Studimi i Fuqisë Punëtore (SFP), ose përndryshe, nga të dhënat administrative të Ministrisë së Punës dhe/ose shërbimeve të punësimit.²¹

- *Tendencat demografike* sipas grupmoshave kryesore [të ndara sipas gjinisë për fëmijët (0-14), të rinjtë (15-24), të rriturit (25-64) dhe të moshuarit (65+)] dhe projeksionet.
- *Pjesëmarrja e fuqisë punëtore*, popullsia ekonomikisht aktive (shuma e punësimit të përgjithshëm dhe papunësisë së përgjithshme) – numri bruto dhe si pjesë e popullsisë në moshë pune (përqindja e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore), të ndara sipas gjinisë, moshës (15 – 24 dhe 25+), nivelit arsimor dhe vendbanimit urban/rural.
- *Përqindja e punësimit*, raporti i popullsisë në punë kundrejt popullsisë në moshë pune, i ndarë sipas gjinisë, moshës (15-24 dhe 25+), nivelit arsimor dhe urban/rural.
- *Punësimi sipas sektorit dhe statusit* – të punësuarit të ndarë sipas sektorit të detajuar ekonomik (p.sh. bujqësi, miniera dhe karriera, manifaktura, tregti, hotelieri dhe turizëm, etj.) dhe të punësuarit sipas statusit të punësimit (punësim me pagë, vetëpunësim – me apo pa punëtorë – dhe punë familjare pa pagesë), të ndarë sipas gjinisë, moshës (15-24 dhe 25+) dhe urban/rural.
- *Punësimi në sektorin publik apo privat*, i ndarë sipas gjinisë, moshës (15-24 dhe 25+), dhe urban/rural.
- *Punësimi sipas orëve të punës* (i llogaritur zakonisht në orë javore – p.sh. < 20, 20-29, 30-39, 40-49, > 50), i ndarë sipas gjinisë, moshës (15-24 dhe 25+), dhe urban/rural.
- *Punësimi sipas qëndrueshmërisë në vendin kryesor të punës* (punë e përhershme apo e përkohshme), i ndarë sipas gjinisë, moshës (15-24 dhe 25+) dhe urban/rural.²²
- *Punësimi informal*, informacion, nëse ka, mbi punësimin në ekonominë informale dhe, nëse është e mundur, sipas sektorit ekonomik, statusit të punësimit, gjinisë, moshës, arsimit dhe vendbanimit urban/rural.²³

²⁰ Të dhënat duhet të shoqërohen me informacion rreth kufizimeve gjeografike dhe/ose të mbulueshmërisë së burimit.

²¹ Në rastin e fundit, duhet treguar se të dhënat rreth papunësisë i referohen vetëm “të papunëve të regjistruar”

²² Duhet treguar qartë përkufizimi i përdorur për të bërë dallimin ndërmjet punësimit të përhershëm dhe të përkohshëm.

²³ Duhet treguar qartë përkufizimi që përdoret për të përcaktuar punësimin informal.

- *Papunësia* sipas gjinisë, moshës, arsimit dhe urban/rural. Aty ku është e mundshme, duhet bërë ndarja sipas kohëzgjatjes së papunësisë. Kjo është sidomos e rëndësishme për përcaktimin e papunësisë afatgjatë (d.m.th. > 12 muaj).
- *Punësimi jo i plotë lidhur me kohën* ²⁴ sipas gjinisë, moshës, arsimit, sektorit ekonomik, urban/rural.
- *Përqindja e inaktivitetit* ²⁵ sipas gjinisë, moshës, arsimit dhe urban/rural. Nëse është e mundshme, të bëhet ndarja sipas arsyeve të inaktivitetit në mënyrë që të kapet numri i “punëtorëve të dekurajuar”.
- *Përqindja e vijueshmërisë në arsim dhe e analfabetizmit* sipas gjinisë, moshës, urban/rural.
- *Niveli i pagave dhe të ardhurave* sipas gjinisë, moshës, arsimit, profesionit, sektorëve privat/publik, dhe vendbanimit urban/rural.
- *Siguria dhe shëndeti në punë* – numri i sëmundjeve të shkaktuara nga puna, i vdekjeve të shkaktuara nga sëmundjet në punë, aksidentet fatale dhe jofatale, numri i aksidenteve që kanë shkaktuar mungesë në punë për 3 apo më shumë ditë, sipas gjinisë dhe moshës (nëse është e mundur).

²⁴ Përkufizimi ndërkombëtar i punësimit jo të plotë lidhur me kohën përfshin të gjithë personat e punësuar, orët e punës së të cilëve « janë të pamjaftueshme në raport me një situatë tjetër punësimit ku këta persona dëshirojnë dhe janë të gatshëm të angazhohen ». Nëse i bëhen ndryshime përkufizimit ndërkombëtar, ato duhen treguar qartë.

²⁵ Përqindja e inaktivitetit përcaktohet si përqindje e popullsisë në moshë pune që as nuk punon dhe as kërkon punë. Nëse përcaktohen arsyet e inaktivitetit, ky tregues lejon të kapen punëtorët e dekurajuar (d.m.th. ata që për shkak të mungesës [së perceptuar] të suksesit kanë pushuar së kërkuari punë, edhe pse janë të gatshëm dhe të aftë për punë).

Mjeti 3

Listë-kontrolli i treguesve kryesorë të tregut të punës së të rinjve

Treguesit e tregut të punës së të rinjve*	
Popullsia	Tendencat demografike me projeksionet, përfshirë përqindjen e lindshmërisë si dhe përqindjen e fëmijëve dhe të moshuarve në varësi
Arsimi	Vijueshmëria e arsimit
	Studentët në arsim
	Numri i braktisjeve të shkollës
	Përqindja e regjistrimit dhe e atyre që dinë shkrim dhe lexim
Fuqia punëtore	Pjesëmarrja e të rinjve në fuqinë punëtore gjatë dekadës së kaluar
	Tendencat e punësimit të të rinjve ☐ Përqindja e punësimit ☐ Punësimi sipas sektorit ekonomik dhe statusit ☐ Sektori publik apo privat ☐ Orët e punës (përfshirë edhe punën me kohë të pjesshme me dëshirë & pa dëshirë)
	Punësimi sipas llojit të kontratës dhe statusit në punën kryesore; kur ka mundësi, informacioni duhet dhënë sipas sektorëve të ekonomisë ☐ Me kohë të plotë, të pjesshme, i përhershëm ose i përkohshëm ☐ Punëtorë me pagë, të vetëpunësuar, që kontribuojnë në familje.
	Punësimi informal, kur ka mundësi, informacioni duhet dhënë sipas sektorëve ekonomikë dhe statusit në punësim
	Punësim jo i plotë lidhur me kohën, kur ka mundësi, informacioni duhet dhënë sipas sektorëve ekonomikë dhe statusit në punësim
	Tendencat e papunësisë së të rinjve Kur ka mundësi të ndahen sipas kohëzgjatjes, veçanërisht për papunësinë afatgjatë (> 12 muaj).
	Të rinjtë në raport me përqindjen e papunësisë së përgjithshme, (pjesa e përqindjes së papunësisë së të rinjve në përqindjen e papunësisë së përgjithshme)
	Të rinjtë në raport me përqindjen e papunësisë së të rriturve (pjesa e përqindjes së papunësisë së të rinjve në përqindjen e papunësisë së të rriturve)
Inaktiviteti	Përqindja e inaktivitetit dhe dekurajimi Nëse është e mundur të përmenden arsyet e inaktivitetit për të kapur dekurajimin e punëtorëve
Pagat dhe kushtet e punës	Pagat dhe përfitimet sipas sektorit dhe profesionit nëse është e mundur.
	Shëndeti dhe siguria në punë sipas sektorit nëse është e mundur ☐ Numri i sëmundjeve të shkaktuara në punë ☐ Vdekjet e shkaktuara si pasojë e sëmundjeve në punë. ☐ Aksidentet fatale dhe jo fatale. ☐ Numri i aksidenteve në punë që shkaktojnë mungesa për tri ose më shumë ditë
	Puna e fëmijëve - numri i të rinjve me moshë 15-17 vjeç në format më të këqija të punës së fëmijëve, sipas gjinisë dhe sektorit (shih Konventën Nr. 182, Format më të këqija të punës së fëmijëve, 1999)

*Të ndarë sipas gjinisë, grupmoshave, grupeve etnike, të rinj me paafësi, HIV/AIDS, punëtorë migrantë, rural/urban, nivelit arsimor.

Mjeti 4

Matricat për përshkrimin e niveleve të ndryshme të sistemit arsimor

NIVELI ISCED	Emri i nivelit	Përshkrimi i nivelit
0	Arsimi parashkollor	Niveli fillestar i të mësuarit të organizuar, i dizajnuar kryesisht për t'i futur fëmijët në një mjedis shkolle, domethënë shërben si urë mes shtëpisë dhe mjedisit shkollor.
1	Arsimi fillor (ose niveli i parë i arsimit bazë)	Programet në këtë nivel i pajisin nxënësit me një edukim bazë në lexim, shkrim dhe matematikë si dhe njohuri elementare në disa lëndë (p.sh. histori, gjeografi, shkenca natyrore, shkenca shoqërore). Shkollimi normalisht fillon në moshën 5-7 vjeç, është i detyrueshëm në të gjitha rastet dhe, si rregull, zgjat 5 ose 6 vjet.
2	Arsimi dytësor më i ulët (ose niveli i dytë i arsimit bazë)	Programet janë dizajnuar të tilla që plotësojnë arsimin bazë që nis në arsimin fillor. Në shumicën e vendeve, qëllimi edukativ i tyre është të vendosë bazat për mësim gjatë gjithë jetës. Zakonisht, programet janë të orientuara më shumë drejt lëndëve dhe, për to, përdoren mësues më të specializuar dhe, shpesh, mësuesit që japin mësim në fushën e specialitetit të tyre janë disa. Në këtë nivel merren aftësitë bazë në mënyrë të plotë. Fundi i tij shpesh përkon me përfundimin e arsimit të detyrueshëm.
3	Arsimi dytësor më i lartë	Ky nivel arsimi fillon pas ciklit të plotë të arsimit të detyrueshëm për ato vende që kanë një sistem arsimi të detyrueshëm. Moshë për t'u futur në këtë nivel është zakonisht 15 ose 16 vjeç. Në këtë nivel vërehet një program më i specializuar se në nivelin paraardhës. Programet zakonisht kërkojnë që të jetë përfunduar një arsimim me kohë të plotë prej rreth 9 vitesh (që nga fillimi i nivelit të parë). Programet për këtë nivel përmbajnë arsim të përgjithshëm ose arsim dhe formim profesional.
4	Arsimi post-dytësor (arsimi jo terciar)	Programet në këtë nivel shërbejnë për të zgjeruar njohuritë e pjesëmarrësve që tanimë kanë përfunduar programin e nivelit të 3-të. Ato i përgatisin nxënësit për nivelin e 5-të ose për hyrje të drejtpërdrejtë në tregun e punës.
5	Arsimi terciar (më i lartë)	Programet për këtë nivel kanë një përmbajtje edukative më të avancuar se ato të niveleve 3 dhe 4. Programet mund të jenë: (i) të bazuar në teori ose të ofrojnë qasje në profesione që kërkojnë aftësi të larta (rrjedhë e gjatë); ose (ii) praktike/teknike/ specifike sipas profesionit (rrjedhë e shkurtër).
6	Arsimi terciar i avancuar	Ky nivel është i rezervuar për programet terciare që kualifikojnë për punë kërkimore të avancuar. Ndaj programet i kushtohen studimit të avancuar dhe punës kërkimore të mirëfilltë.

Burimi: Përshtatur nga UNESCO: Klasifikimi Standart Ndërkombëtar i Arsimit (ISCED), 1997

Mjeti 5

Kriteret për vlerësimin e performancës dhe impaktit të programit/projektit

Kriteri	Përkufizimi	Lista e kontrollit e çështjeve që duhen shikuar
Efektiviteti	Shkalla e arritjes së objektivave dhe efektet e programit/projektit te grupet e synuara.	Progresi i bërë drejt përmbushjes së objektivave si dhe arritjet dhe/ose problemet kryesore. Përfituesit e synuar dhe/ose përfituesit e drejtëpërdrejtë. Duhet dhënë informacion lidhur me karakteristikat e tyre, siç janë mosha, gjinia, përkatësia etnike, niveli social-ekonomik, vendndodhja gjeografike dhe sektori ekonomik. Numri dhe/ose lloji i përfituesve të synuar dhe/ose përfituesve të drejtëpërdrejtë që janë shërbyer krahasuar me planin fillestar. Arsyet dhe natyra e ndryshimeve, nëse ka. Efektet e programit/ projektit në situatën e përfituesve të synuar dhe/ose përfituesve të drejtëpërdrejtë. Faktorët e brendshëm dhe/ose të jashtëm që kanë ndikuar (pozitivisht ose negativisht) në arritjen e objektivave.
Eficienca dhe efektiviteti i koston	Përdorimi i burimeve të alokuara krahasuar me rezultatet e arritura.	Rezultatet e programit/ projektit krahasuar me shpenzimet e kryera. Për shembull, eficientia e një programi trajnimi do të përcaktohet si shkalla në të cilën u përdor minimumi i burimeve financiare për të zhvilluar dhe zbatuar programin e trajnimit (e vlerësuar, për shembull, me koston për një të trajnuar), ndërsa efektiviteti i koston së trajnimit krahason përfitimet e trajnimit me koston e gjenerimit të këtyre përfitimeve (e vlerësuar, për shembull, me koston e çdo vendi pune të krijuar).
Impakti	Vendet e punës për të rinjtë që, pa ndërhyrjet, nuk do të ishin krijuar.	Numri i atyre që siguruan vende pune, numri i atyre që siguruan vend pune me pagë, të ardhurat mesatare të tyre, llojet e kontratave të tyre (pa afat, të përkohshme, me kohë të pjesshme), orët e punës, krahasuar me një grup kontrolli të cilin nuk e ka prekur ndërhyrja.
Qëndrueshmëria	Jetëgjatësia e efekteve pas përfundimit të ndërhyrjes.	Kapaciteti (institucional, menaxherial, teknik dhe financiar) i përfituesve të drejtëpërdrejtë për të vazhduar/zhvilluar më tej aktivitetet e ndërmarra nga projekti/programi pas përfundimit të tij. Masat e inkomporuara në projekt/ program për të siguruar qëndrueshmëri financiare pas përfundimit të projektit/ programit (p.sh. operimi i një skeme kredie, shërbimet e ndryshme tregtare dhe aktivitete të tjera që gjenerojnë të ardhura).

Mjeti 6

Shembulli i çështjeve dhe pyetjeve për vlerësimin e PKA-së

Çështjet e vlerësimit	Shembull i pyetjeve të vlerësimit
Arsyetimi i PKA-së (A ka kuptim Plani i Aksionit)	☐ Në ç'masë objektivat dhe mandati i Planit të Aksionit janë ende relevantë? ☐ A janë aktivitetet dhe rezultatet e Planit të Aksionit në pajtim me mandatin e tij dhe bindshëm të lidhur me arritjen e objektivave dhe impaktit të synuar?
Impakti dhe efekti (Çfarë ka ndodhur si rezultat i Planit të Aksionit?)	☐ Çfarë impakti, i pritshëm dhe jo-i pritshëm, rezulton nga kryerja e Planit të Aksionit ? ☐ Në ç'mënyrë dhe në ç'masë Plani i Aksionit plotëson, përsërit, mbivendos apo është në kundërshtim me programet e tjera?
Arritja e objektivave (A e ka arritur Plani i Aksionit atë çka pritej?)	☐ Në ç'mënyrë dhe në ç'masë u arritën objektivat si rezultat i Planit të Aksionit?
Alternativat (A ka mënyra më të mira për të arritur rezultatet?)	☐ A ka programe me kosto më efektive që të kenë arritur objektivat dhe impaktin e synuar? ☐ A ekzistojnë mënyra me kosto më efektive për të livruar atë çka parashikohej nga Plani i Aksionit?

Mjeti 7

Modeli i matricës së PKA-së

Objektivi i punësimit të të rinjve						
Synimi:						
Rezultati (outcome)	Treguesit	Njësia përgjegjëse	Inputet financiare		Kalendari kohor	
			Buxhetore	Ekstra- buxhetore	Data e fillimit	Data e perfundimit
Rezultati 1	Treguesi 1.1	Ministria X	US\$ 2 milionë	US\$ 1 milionë	dd.mm.vv	dd.mm.vv
	Treguesi 1.2					
	Treguesi 1.n					
Rezultati 2	Treguesi 2.1	Ministria Y	US\$ 3 milionë	US\$ 2 milionë	dd.mm.vv	dd.mm.vv
	Treguesi 2.2					
	Treguesi 2.n					
Rezultati 3	Treguesi 3.1	Ministria Z	US\$ 2 milionë	-	dd.mm.vv	dd.mm.vv
	Treguesi 3.2					
	Treguesi 3.n					
Rezultati n	Treguesi n.1	SHPP	US\$ 1 milionë	US\$ 2 milionë	dd.mm.vv	dd.mm.vv
	Treguesi n.2					
	Treguesi n.n					

Mjeti 8

Modeli i propozuar i Planit të Punës së PKA-së

		Data e fillimit	Data e mbarimit	Personi përgjegjës	Viti 1 (muaji)												Viti 2 (muaji)					
					1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	1	2	3	4	n.	12
1	SHËNO REZULTATIN (OUTCOME) 1																					
1.1	Përshkruaj rezultatin (output) 1			Menaxheri																		
A.1.1.1	Përshkruaj aktivitetin 1			Z./Znj.																		
A.1.1.2	Përshkruaj aktivitetin 2			Z./Znj.																		
A.1.1.n	Përshkruaj aktivitetin n			Z./Znj.																		
1.2	Përshkruaj rezultatin (output) 2			Menaxheri																		
A.1.2.1	Përshkruaj aktivitetin 1			Z./Znj.																		
A.1.2.2	Përshkruaj aktivitetin 2			Z./Znj.																		
A.1.2.n	Përshkruaj aktivitetin n			Z./Znj.																		
1.n	Përshkruaj rezultatin (output) n			Menaxheri																		
A.1.n.1	Përshkruaj aktivitetin 1			Z./Znj.																		
A.1.n.2	Përshkruaj aktivitetin 2			Z./Znj.																		
A.1.n.n	Përshkruaj aktivitetin n			Z./Znj.																		
N	SHËNO REZULTATIN N																					
n.1	Përshkruaj rezultatin (output) 1			Menaxheri																		
A.n.1.1	Përshkruaj aktivitetin 1			Z./Znj.																		
A.n.1.2	Përshkruaj aktivitetin 2			Z./Znj.																		
A.n.1.n	Përshkruaj aktivitetin n			Z./Znj.																		
n.2	Përshkruaj rezultatin (output) 2			Menaxheri																		
A.n.2.1	Përshkruaj aktivitetin 1			Z./Znj.																		
A.n.2.2	Përshkruaj aktivitetin 2			Z./Znj.																		
A.n.2.n	Përshkruaj aktivitetin n			Z./Znj.																		
n.n	Përshkruaj rezultatin (output) n			Menaxheri																		
A.n.n.1	Përshkruaj aktivitetin 1			Z./Znj.																		
A.n.n.2	Përshkruaj aktivitetin 2			Z./Znj.																		
A.n.n.n	Përshkruaj aktivitetin n			Z./Znj.																		

Mjeti 9

Modeli i propozuar për skicë-projektin e PKA-së

TITULLI I PROJEKTIT	
Përshkrimi i projektit	Përshkruhen komponentët kryesorë të projektit, grupet e synuara, strategjia e zbatimit dhe rregullimet institucionale
Lidhja me PKA-në	Tregohet se si do të kontribuojë projekti në arritjen e njërit prej objektivave të PKA-së për punësimin e të rinjve?
Objektivat imediatë të projektit	Formulohen objektivat që duhen arritur nga projekti. Këto objektiva duhet të korrespondojnë me një ose më shumë rezultate (outcome) të PKA-së.
Treguesit e performancës së projektit	Formulohen (në terma sasiorë) treguesit e performancës që i bashkëngjiten secilit objektiv të projektit.
Rezultatet (outputs) e projektit	Tregohen rezultatet kryesore që duhen prodhuar me qëllim që të arrihen objektivat e projektit.
Buxheti	Tregohen burimet financiare të nevojshme për projektin.
Kontaktet	Emri dhe të dhënat e kontaktit të personit apo njësisë përgjegjëse.

Mjeti 10

Normat Ndërkombëtare të Punës për punën dhe të rinjtë ²⁶

Liria e organizimit, bisedimit kolektiv dhe marrëdhëniet e punës

- ☐ Konventa për Lirinë e organizimit dhe Mbrojtjen e të Drejtës për t'u Organizuar, 1948 (Nr. 87)*²⁷
- ☐ Konventa për të Drejtën për t'u Organizuar dhe Bisedim Kolektiv, 1949 (Nr. 98)*
- ☐ Konventa për Përfaqësuesit e Punëtorëve (Nr. 135) dhe Rekomandimi (Nr. 143), 1971

Puna e detyruar

- ☐ Konventa për Punën e Detyruar, 1930 (Nr.29)*
- ☐ Rekomandimi për Punën e Detyruar (Detyrimi Jo-i drejtpërdrejtë), 1930 (Nr. 35)
- ☐ Konventa për Heqjen e Punës së Detyruar, 1957 (Nr. 105)*

Eliminimi i punës së fëmijëve dhe mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve

- ☐ Konventa për Moshën Minimale (Nr. 138)* dhe Rekomandimi (Nr. 146), 1973
- ☐ Konventa për Format më të Këqija të Punës së Fëmijëve (Nr. 182)* dhe Rekomandimi (Nr. 190), 1999
- ☐ Konventa për Ekzaminimin Mjekësor të të Rinjve (Industri), 1946 (Nr. 77)
- ☐ Konventa për Ekzaminimin Mjekësor të të Rinjve (Profesionet Jo-Industriale), 1946 (Nr. 78)
- ☐ Rekomandimi për Ekzaminimin Mjekësor të të Rinjve, 1946 (Nr. 79)

Barazia në mundësi dhe trajtim

- ☐ Konventa për Shpërblim të Barabartë (Nr. 100)* dhe Rekomandimi (Nr.90), 1951
- ☐ Konventa për Diskriminimin (në Punësim dhe Profesion) (Nr. 111)* dhe Rekomandimi (Nr.111), 1958

Inspektimi dhe administrata e punës

- ☐ Konventa për Inspektimin në Punë (Nr. 81) dhe Rekomandimi (Nr. 81),1947
- ☐ Konventa për Protokollin e 1995 për Inspektimin në Punë, 1947 (Nr.81)
- ☐ Konventa për Inspektimin në Punë (Bujqësi)(Nr. 129) dhe Rekomandimi (Nr. 133), 1969
- ☐ Konventa për Administratën e Punës (Nr. 150) dhe Rekomandimi (Nr. 158), 1978

²⁶ Teksti i plotë i këtyre Normave Ndërkombëtare të Punës gjendet në faqen e internetit të ONP-ës në adresën e mëposhtme:
<http://www.ilo.org/youth>

²⁷ Shenja e yllit tregon tetë Konventat themelore të ONP-ës.

Politikat dhe nxitja e Punësimit

- Konventa për Politikën e Punësimit (Nr. 122) dhe Rekomandimi (Nr. 122), 1964
- Rekomandimi për Politikën e Punësimit (Dispozita shpeshë) (Nr. 169), 1984
- Konventa për Rehabilitimin Profesional dhe Punësimin (Personat me Aftësi të Kufizuar) (Nr. 159) dhe Rekomandimi (nr. 168), 1983
- Konventa për Agjencitë Private të Punësimit (Nr. 181) dhe Rekomandimi (Nr. 188), 1997
- Konventa për Shërbimet e Punësimit (Nr. 88) dhe Rekomandimi (Nr. 83), 1948
- Rekomandimi për Krijimin e Punës në Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme 1998 (Nr. 189)
- Rekomandimi për Nxitjen e Kooperativave, 2002 (Nr. 193)

Orientimi dhe formimi profesional

- Konventa për Zhvillimin e Burimeve Njerëzore, 1975 (Nr. 142)
- Rekomandimi për Zhvillimin e Burimeve Njerëzore, 2004 (Nr. 195)

Pagat

- Konventa për Mbrojtjen e Pagave (Nr. 95) dhe Rekomandimi (Nr. 85), 1949
- Konventa për Caktimin e Pagës Minimale (Nr. 131) dhe Rekomandimi (Nr. 135), 1970

Koha e punës

- Konventa për Orët e Punës (Industri), 1919 (Nr. 1)
- Konventa për Orët e Punës (Tregti dhe Zyra), 1930 (Nr. 30)
- Konventa për Punën e Natës (Nr. 171) dhe Rekomandimi (Nr. 178), 1990
- Konventa për Punën me Kohë të Pjesshme (Nr. 175) dhe Rekomandimi (Nr. 182), 1994

Siguria dhe Shëndeti në Punë

- Konventa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (Nr. 155) dhe Rekomandimi (Nr. 164), 1981
- Protokoll i 2002 për Konventën për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 1981 (Nr. 155)
- Konventa për Sigurinë dhe Shëndetin në Bujqësi (Nr. 184) dhe Rekomandimi (Nr. 192), 2001

Sigurimet shoqërore

- Konventa për Sigurimet Shoqërore (Standardet Minimale), 1952 (Nr. 102)
- Konventa për Nxitjen e Punësimit dhe Mbrojtjen nga Papunësia (Nr. 168) dhe Rekomandimi (Nr. 176), 1988

Mbrojta e amësisë

- Konventa për Mbrojtjen e Shtatzanisë (Nr.183) dhe Rekomandimi (Nr.191), 2000

Punëtorët migrantë

- Konventa për Migrimin për Punësim (e Rishikuar) (Nr.97) dhe Rekomandimi (i Rishikuar) (Nr. 86), 1949
- Konventa për Punëtorët Migrantë (Dispozita Shtesë), 1975 (Nr. 143)
- Rekomandimi për Punëtorët Migrantë, 1975 (Nr. 151)

Popujt indigjenë dhe tribalë

- Konventa për Popujt Indigjenë dhe Tribalë, 1989(Nr.169)

Programi për Punësimin e të Rinjve
Sektori i Punësimit
Organizata Ndërkombëtare e Punës
4, Route des Morillons
CH-1211 Geneva 22
Tel.: +41 22 799 68 53
Fax: +41 22 799 75 62
E-mail: youth@ilo.org
Web site: www.ilo.org/youth

978-92-2-120616-3



9 789221 206163